

**CALL YOUR COUNTRY**  
 FOL ME VENDIN TËND  
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.  
**WIND**  
 Informacione në wind.it



E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.1 - GENNAIO/JANAR 2009 - € 1,50

# shqiptari i italisë

*l'albanese d'italia*

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543

**CALL YOUR COUNTRY**  
 FOL ME VENDIN TËND  
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.  
**WIND**  
 Informacione në wind.it



## GËZIM HAJDARI murgu endacak i poezisë

Ose Poeti Migrues, më i pranishmi shkrimtar shqiptar në gjithë antologjitë botërore të poezisë. Kritikë të kalibrit të rëndë nuk ngurrojnë ta quajnë një ndër poetët më të mëdhenjë të gjallë në botë. E megjithatë, Gëzim Hajdari rri mbyllur në asketizmin e vet migrues nga ku buron edhe poezia e tij dygjuhëshe, si dyzimi që mbart me vete.



### MË KAP DOT?

Udhëzues mbi të drejtat e tua

Ç'të drejta ka kush është pa leje qëndrimi? Si duhet të silllet nëse ndalohe nga forcat e ruajtjes së rendit? Në ç'raste mund të kontrollohet?

Kontrollori i biletave në tren a mund t'i kërkojë të paraqesë dokumentin e qëndrimit? Po në spital a mund të shkojë për t'u kuruar pa rrezikuar të dëbohet nga Italia?



### Shqipëria dhe Shqiptarët e Ismail Vlorës

Një artikull i Ismail Qemalit botuar më 1917 në londinezin «Quarterly Review» është rimarrë e përpunuar nga stërnipi i tij Darling Vlorë i cili, duke e mbushur me shënime plotësuese e ilustrime, ia ka zgjeruar tablonë historike duke e shëndërruar në një libër të plotë dygjuhësh



**WESTERN UNION**  
 MONEY TRANSFER

Vodafone One Nation 12  
**Tani mjaftojnë 12 cent**  
 për t'u ndjerë pranë familjes  
 Life is now



## KONTROLLI I DOKUMENTEVE, IDENTIFIKIMI DHE NDALIMI

**N**ëpunësit e rendit (policisë së shtetit, karabinierët, dhe të tjera trupa që i pëkasin ushtrisë, policisë bashkiake - por këta të fundit vetën nëse kanë cilësinë e agjentit të policisë së sigurimit) mund të të detyrojnë t'i ndjekësh në zyrat e tyre, nëse refuzon të deklarosh gjeneralitetet e tua (emrin, mbiemrin, vendin dhe ditën e lindjes) apo të tregosh dokumente identifikimi, apo nëse ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për faktin se emri apo dokumentet që ke dhënë janë të rreme (neni 11, dekreti legjislativ 21,3,1978 nr. 59): ky quhet ndalim për arsye identifikimi ose shoqërim.

Punonjësit e rendit që të shoqërojnë në kuesturë për të të identifikuar duhet të njoftojnë menjëherë Prokurorin e Republikës, dhe mund të të mbajnë për sa kohë që nevojitet për të të identifikuar, sidoqoftë duhet të të lënë të lirë brenda 24 orësh. Për të të identifikuar mund të të fotografojnë apo të të marrin

shenjat e gishtërinjve, edhe pa autorizimin tënd. Nuk mund të të marrin flokë apo pështymë pa autorizimin tënd, me përjashtim të rastit kur këtë e autorizon një gjykatës.

”

Punonjësit e rendit që të shoqërojnë në kuesturë për të të identifikuar duhet të njoftojnë menjëherë Prokurorin e Republikës, dhe mund të të mbajnë për sa kohë që nevojitet për të të identifikuar, sidoqoftë duhet të të lënë të lirë brenda 24 orësh.

Nuk parashikohet marrja e një mbrojtësi në të tilla raste.

Por është e rëndësishme - dhe ke të drejtë ta kërkojë - që njoftimi Prokurorit të Republikës, të bëhet menjëherë nga momenti i shoqërimit, sepse vetëm nga ky moment numërohen 24 orët brenda të cilave duhet të të lënë të lirë.

Nëse refuzon të thuash të dhënat e tua personale, apo të tregosh dokumentet, përveç shoqërimit në kuesturë, për të cilën u fol më lart, mund të të denoncojnë për këto vepra penale:

**C**drejta ka kush është pa leje qëndrimi? Si duhet të sillt nëse ndalohet nga forcat e ruajtjes së rendit? Në ç'raste mund të kontrollohet? Kontrollori i biletave në tren a mund t'i kërkojë të paraqesë dokumentin e qëndrimit? Po në spital a mund të shkojë për t'u kuruar pa rrezikuar të dëbohet nga Italia?

Këto janë disa nga pikëpyetjet të cilave u jep përgjigje "vademekumi i përballimit të paketës së sigurisë", realizuar nga bashkëpunimi mes shoqatave të ndryshme lokale e kombëtare, mes të cilave edhe Naga (shoqatë vullnetare për asistencën social-shëndetësore dhe për të drejtat e të huajve dhe të romëve) e Milanos.

Vademekumi është menduar si një mjet për të ndihmuar të huajt dhe operatorët që punojnë me ta. Ai mund të bëhet shkas për sinjalizime, denoncime apo rrëfime historik si dhe të jetë i dobishëm në raste shkeljesh ligjore ndaj të huajve. "Të njohësh të drejtat e detyrat ndihmon për të luftuar abuzimet e diskriminimin, dhe për të përmirësuar integritetin" thonë autorët e vademekumit.

"Pas shumë paketash sigurie, ja një udhëzues për t'u bërë ballë që u përgjigjet nevojave të natyrës pragmatike, por që është, njëherazi, provokacion për të gjitha qeveritë që gjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë ditur të sjellin në fuqi vetëm ligje të frymëzuara ekskluzivisht nga logjika e dashit të kurbanit" shpjegon Pietro Massarotto, president i Naga-s.

"Nuk është një udhëzues për të të mësuar se si t'ia hedhësh, por thjesht një renditje e normave në fuqi. Dëshmitë që mbledhim çdo ditë tregojnë që shtetasit e huaj shpesh nuk i njohin këto norma, por edhe kur i njohin nuk ndihen të sigurt të ushtrojnë të drejtat e tyre për shkak të kriminalizimit të vazhdueshëm të statusit të tyre". Nënvizon Massarotto.

Naga është një shoqatë vullnetarizmi laike dhe jopartiake, që ka lindur në Milano në vitin 1987 për të promovuar e mbrojtur pa diskriminim të drejtat e të gjithë të huajve. Mëse 300 vullnetarët e saj u ofrojnë falas asistencë shëndetësore, ligjore dhe shoqërore emigrantëve, të rregullt e klandestinë, romëve, refugjatëve, viktimave të torturave, si dhe organizojnë veprimtari të ndryshme formimi, komunikimi dhe dokumentimi.

- nëse je shtetas italian apo i BE-së, dhe refuzon të thuash emrin tënd, mund të denoncohesh dhe rrezikon arrestimin deri në 1 vit (neni 651 i kodit penal). Nëse nuk tregon

dokumentet mund të denoncohesh dhe rrezikon dënimin deri në dy muaj heqje lirie (neni 294 i rregullores zbatuese të tulps (Testo Unico delle Leggi di pubblica Sicurezza) dhe neni 221 tulps).

- nëse nuk je shtetas i BE-së, dhe refuzon të tregosh dokumentet (pasaportë dhe leje-qëndrimi) pa ndonjë motiv të vlefshëm, kur punonjësit e rendit të kërkojnë një gjë të tillë, mund të të denoncojnë dhe rrezikon dënimin deri në 6 muaj; nëse ka arsye për të dyshuar rreth identitetit tënd, mund të shoqërohesh në kuesturë për marrjen e shenjave të gishtërinjve dhe të fotografisë (për, e shumta, 24 orë) - neni 6 i dekretit ligjor nr. 28/98.

Nëse i jep të dhëna personale të pavërteta një zyrtari shteti, apo një të ngarkuari të shërbimeve shtetërore, vepra penale dënohet me dënim më të mëdha (të cilat janë rënduar me paketën e sigurisë - dekreti ligj 23.5.2008, nr. 92):

nëse deklaron me gojë apo me shkrim të dhëna person-



Ç'të drejta ka kush është pa leje qëndrimi? Si duhet të sillet nëse ndalohet nga forcat e ruajtjes së rendit? Në ç'raste mund të kontrollohet? Kontrollori i biletave në tren a mund t'i kërkojë të paraqesë dokumentin e qëndrimit? Po në spital a mund të shkojë për t'u kuruar pa rrezikuar të dëbohet nga Italia?

# Më kap dot?



Ja cilat janë të drejtat e tua përballë ligjeve gjithnjë e më shtrënguese kundër emigrantëve. Nuk është një udhëzues për të të mësuar se si t'ia hedhësh, por thjesht një renditje e normave në fuqi. Që shpesh, të huajt nuk i njohin, duke u bërë pre e abuzimeve.

ale të gabuara rrezikon burgosjen deri në, e shumta, gjashtë vjet (neni 495 dhe 496 i kodit penal);

i njëjti dënim parashikohet nëse ndryshon tiparet e tua fizike për të penguar identifikimin - si për shembull ndryshim të gjurmëve të gishtërinjve (neni 495 kodit penal).

Është shtuar edhe masa përkeqësuese në rast klandestiniteti. Kjo do të thotë se dënimi i parashikuar për veprën penale që ke kryer mund të rritet vetëm për faktin se nuk je i pajisur me lejeqëndrimi (neni 61, nr. 11 bis kodit penal).

Nuk ekziston më vepra penale e fyerjes ndaj një nëpunësi të shtetit por mbetet ajo e fyerjes së një personi (neni 594 kodit penal) që përdoret shpesh nga autoritetet, dhe vepra penale e qëndresës përpara nëpunësit të rendit (pra kur dikush i kundërvihet me dhunë apo me kërcënime një nëpunësi të rendit apo një të ngarkuari të shërbimeve

shtetërore ndërsa ky i fundit është duke zbatuar detyrën (neni 337 i kodit penal). Mund të të akuzojnë për veprën penale të qëndresës (edhe) nëse përdor dhunë apo kërcënon një të ngarkuar me punë nga shërbimet shtetërore, apo vartësve të policive private pranë stacioneve të trenave, metrosë apo në autobusë, sepse konsiderohen si ndihmës të rendit dhe sigurisë publike.

Është e rëndësishme të dihet se me dhunë apo kërcënim nënkuptohet çfarëdo gjë që konsiston në kundërshtim të ndryshëm nga qëndresa pasive (për shembull nëse të bllokojnë fizikisht dhe kërkon të çlirohesh apo në mbrohesh në çfarëdo mënyre do të akuzohesh për qëndresë). Në këtë rast dënimi i parashikuar është nga 6 muaj deri në 5 vjet.



## Çfarë duhet të bësh nëse të ndalon e të kërkon dokumentet ...

### NJË AGJENT POLICIE APO KARABINIER

Nëse ai që të kontrollon është një polic i veshur civil duhet në fillim të identifikohet (të tregojë gjeneralitetet, numrin e amzës, njësisë së përkatësisë) dhe të tregojë distinktivin; nëse nuk bën këtë nuk je i detyruar të ndjekësh urdhrat e tij.

Në zyrat e policisë këshillohet gjithmonë të kërkohej distinktivi i identifikimit, të shënohet targa e makinës, të shkruhet emri i policëve që të marrin në pyetje, apo që bëjnë procesin verbal dhe të kërkohej një kopje e asaj që të thonë të firmosësh; këto gjëra shërbejnë për të denoncuar parregullsitë apo eventualisht sjelljen prepotente,

### NJË USHTAR I USHTRISË ITALIANE

Ushtarët që janë në shërbim në qytete kanë statusin e punonjësit të rendit publik por nuk mund të kryejnë funksionet e policisë gjyqësore. Kjo do të thotë se si policia ashtu edhe karabinierët mund:

- 1) të të kërkojnë të dhënat personale dhe dokumentet e identitetit
- 2) të të çojnë në kuesturë për identifikim (arrest identifikimi)
- 3) mund të të kontrollojnë ty dhe makinën tënde por vetëm në raste të veçanta urgjence ku nuk lejon ndërhyrjen e gjykatësit apo nëse duhet të verifikojnë praninë eventuale të armëve apo eksplozivëve e drogës kur sjellja e personit në fjalë nuk është e justifikueshme.

Përveç këtyre rasteve nuk mund të të kontrollojnë dhe kontrollat nuk janë të ligjshme. Dhe gjithmonë duhet të mbahet një proces verbal dhe duhet të të japin një kopje (neni 4L, 22 maj 1975, n.152)

### NJË AGJENT I POLICISË BASHKIAKE

Agjentët e policisë bashkiake janë nëpunës shtetërore dhe pothuaj gjithmonë bëjnë pjesë në forcat e rendit publik (por mund edhe të mos jenë) dhe zhvillojnë detyra policie gjyqësore ose administrative. Prandaj mund të të arrestojnë dhe të të çojnë në kuesturë, komisariat apo në komandë për të të identifikuar.

Nëse nuk mbulojnë funksione policie gjyqësore nuk mund:

- të të detyrojnë të japësh deklarata apo të të detyrojnë me forcë për të tjera veprime;
- të të shoqërojnë me forcë në zyrat e policisë gjyqësore
- të inspektojnë shtëpinë tënde, kamperin, tendën, apo makinën me përjashtim të rasteve kur

vijon nga faqja 3

ligji autorizon shprehimisht një gjë të tillë.

Nuk ka një mënyrë të qartë që identifikon funksionet e agjentit të policisë bashkiake në atë moment, por është gjithmonë e mundur që të ngrihet kjo çështje.

Paketa e sigurisë u ka dhënë më shumë kompetenca kryetarëve të bashkive prandaj është e mundur që këta të fundit të marrin masa që kufizojnë lirinë personale (gjoba për ata që pinë pije alkoolike në rrugë ose ata që gjenden në grup në disa vende të caktuara etj) dhe që ndërhyrjet e policisë bashkiake kundër shitësve ambulante të jenë më të shpeshta.

Në rast sekuestrimi të mallit gjatë një shitjeje ambulante autoritetet e policisë duhet të bëjnë një proces verbal dhe t'ia dorëzojnë të interesuarit. Nëpunësi i shtetit që merr, shkatërron, (përveç rasteve të parashikuara me ligj) apo shpërdoron sendet që i nënshtrohen sekuestrimit (neni 334 kodi penal: "rëmbim apo dëmtim i sendeve nën sekuestrim").

## Nëse një kontrollor të ndalon në autobus apo në tren

Kontrollorët konsiderohen nëpunës shteti (neni 357 kodi penal). Çfarë mund të bëjë:

- Mund të të kërkojë gjeneralitetet (emër mbiemër etj.) dhe nëse refuzon t'ia thuash mund të të akuzojë për veprën penale sipas nenit 651 të kodit penal (shiko sipër);

- mund të të kërkojë të tregosh dokumentet vetëm në rastin kur duhet të japë gjobë (nëse je pa biletë). Nëse nuk i tregon dokumentet mund të të ndalojë dhe të njoftojë policinë për të vazhduar identifikimin tënd. Pra është gjithmonë mirë të blihet bileta.

- ki parasysh që kontrollori nuk është një agjent policie edhe pse nganjëherë sillet si i tillë. Nëse të akuzon për ndonjë vepër penale,

# Çfarë duhet të bësh nëse të ndalon e të kërkon dokumentet një....



”

ki parasysh që kontrollori nuk është një agjent policie edhe pse nganjëherë sillet si i tillë. Nëse të akuzon për ndonjë vepër penale, duhet të të denoncojë si gjithë shtetasit e zakonshëm. Me përjashtim të rastit kur nuk tregojnë dokumentet dhe i duhet të të gjobisë, nuk mund të përdorë forcën apo mjete të tjera për të të detyruar të bësh diçka, nuk mund të të dëbojë, dhe as nuk mund të të ndalojë për të të dorëzuar në polici me qëllim që kjo e fundit të merret me dëbimin.

## VENDE TË TJERA PËRVEÇ AUTOBUSIT DHE TRENIT KU MUND T'JU KONTROLLOJNË APO T'JU NDALIN:

### NË SPITAL

hyrja në strukturat shëndetësore për shtetasit e huaj të parregullt apo klandestinë nuk mund të sjellë asnjë njoftim për autoritetet (neni 35 dekreti legjislativ nr. 286/98); por kur shkohet në spital për plagosje nga vepra penale (për shembull goditje, dhunë seksuale, plagë nga armë zjarri, apo arme të ftohtë, aksident në punë) mjekët janë të detyruar t'i njoftojnë të dhënat policisë; nuk ka një detyrim të tillë për rastet kur njoftimi do të ekspozonte personin ndaj procedimit penal (neni 365



kodi penal); mbrojtja e shëndetit është një e drejtë themelore që u duhet garantuar shtetasve të huaj të pranishëm në mënyrë jo të rregullt në territorin italian: sipas gjykatës së Diktimit mjekimet thelbësore nuk përfshijnë vetëm ndihmën e shpejtë por edhe ndërhyrjet e nevojshme për eliminimin e ndonjë patologjie. Nëse lëshohet një dekret dëbimi për një person që shkon në

vijon në faqen 6

duhet të të denoncojë si gjithë shtetasit e zakonshëm. Me përjashtim të rastit kur nuk tregojnë dokumentet dhe i duhet të të gjobisë, nuk mund të përdorë forcën apo mjete të tjera për të të detyruar të bësh diçka, nuk mund të të dëbojë, dhe as nuk mund të të ndalojë për të të dorëzuar në polici me qëllim që kjo e fundit të merret me dëbimin.

### Prandaj është e rëndësishme:

- të dokumentohet ajo që është duke ndodhur me foto dhe video. Nëse ka furgonë të policisë, të dokumentohet sa dhe cilët janë njerëzit që zbriten nga autobusi dhe që transportohen në furgonët e policisë; të merren numrat e targave;

- të sigurohen njerëz të gatshëm për të dëshmuar, qoftë shtetasit e huaj që pësojnë këto grupime

- të identifikohet ç'njësie i përkasin agjentët (policisë së shtetit, karabinierëve, policisë bashkiake) që kryejnë këto veprime;

- shtetasit e huaj që transportohen me furgonët

e policisë janë të detyruar të tregojnë pasaportat dhe lejeqëndrimet e tyre,

përveç rastit kur ka arsye justifikuese (humbje, vjedhje, lejeqëndrim

i përkohshëm i mbajtur nga të tjerë etj) policia

mund ta shpjerë shtetasin e huaj në kuesturë në rast dyshimi për identitetin e tij;

dyshimi për identitetin e tij; dyshimi nuk mund të bazohet në origjinën e tij etnike apo kombëtare.

Është e këshillueshme të kërkohen menjëherë shpjegime rreth motivit të kontrollit dhe përse një person shoqërohet në kuesturë.

Është mirë që gjithmonë të dilni në çift dhe që në shtëpi të mos jeni vetëm në mënyrë që të ketë dëshmitarë që të tregojnë abuzimet e mundshme nga ana e forcave të rendit.

mund ta shpjerë shtetasin e huaj në kuesturë në rast dyshimi për identitetin e tij; dyshimi për identitetin e tij; dyshimi nuk mund të bazohet në origjinën e tij etnike apo kombëtare.

Është e këshillueshme të kërkohen menjëherë shpjegime rreth motivit të kontrollit dhe përse një person shoqërohet në kuesturë.

Është mirë që gjithmonë të dilni në çift dhe që në shtëpi të mos jeni vetëm në mënyrë që të ketë dëshmitarë që të tregojnë abuzimet e mundshme nga ana e forcave të rendit.

shqiptari i italisë  
l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i  
**Bota shqiptare**  
gazeta e shqiptarëve në itali

BOTIMI / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE È ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DIREKTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORE / IN REDAZIONE

Keti Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

ISTITUTO LUCE  
PRESENTA



# ALBANIA

## IL PAESE DI FRONTE

REGIA  
ROLAND SEJKO  
MAURO BRESCIA



**IL PRIMO DOCUMENTARIO  
SULLA STORIA DELL'ALBANIA**



REGIONE LAZIO

**N E L L E M I G L I O R I L I B R E R I E**

## VENDE TË TJERA KU MUND T'JU KONTROLLOJNË APO T'JU NDALIN:

vijon nga faqja 4

spital për të marrë mjekimet që i nevojiten, dëbimi është i paligjshëm dhe mund të paraqitet ankesë kundër tij.

### NË KUESTURË

- kur shkon në kuesturë për të denoncuar një veprë penale që ke pësuar apo sepse ke humbur apo të kanë vjedhur pasaportën, kujtohu që nëse nuk ke lejeqëndrimi policia mund

Policia nuk mund të kontrollojë një person dhe as të hyjë në një shtëpi private, lokal apo makinë, pa një mandat gjyqësor (pra pa një dokument që të thotë shprehimisht se janë të autorizuar të bëjnë një gjë të tillë).

Nëse kanë këtë mandat i interesuari ka të drejtë:

- para se të fillojë kontrolli të marrë një kopje të mandatit;
- të kërkojë zhvillimin e kontrollit në prani të një avokati apo të një njeriu të besuar (të cilët të jenë të gjtshëm lehtësisht).

Kontrollet pa mandatin gjyqësor mund të bëhen në të tilla raste:

1) kur është duke u kryer një veprë penale, apo një arratisje,

# KONTROLLET NË BANESE

dhe neni 25 dekret ligj 8.6.1992, nr. 306);

Edhe në të tilla raste duhet të të jepet gjithmonë një kopje e proces-verbalit të kontrollit, edhe nëse nuk sekuestrohet asgjë, ku të tregohen veprimet e kryera, arsyen përse është kryer kontrolli pa autorizimin e gjykatësit, emrat dhe cilësinë e agjentëve që kanë bërë kontrollin. Nëse sekuestrojnë objekte, dokumente, duhet të tregohen konkretisht në procesverbalin e kontrollit. Nëse

Pyet gjithmonë për arsyet e kontrollit dhe ki parasysh se përveç rasteve të përkrahura më lart, policia nuk ka të drejtë të hyjë në shtëpinë tënde: nëse policia për shembull paraqitet në shtëpinë tënde, pa mandat, sepse e kanë thirrur fqinjët sepse kishte shumë zhurmë, nuk je i detyruar t'i lësh të hyjnë në shtëpi. Nëse policia hyn në shtëpi me pretekstin për të kontrolluar për armë, dhe lëshon urdhra dëbimi, këto dëbime nuk janë të ligjshme (Gjykata e Triestes 24.7.2004)

duke ia lënë për banim".

Nuk ka rrezik të të denoncojnë për këtë veprim nëse i jep me qira shtëpinë një personi të huaj edhe pse klandesstin, me çmime modeste.



Dëbimi i shtetasit të huaj në momentin e celebrimit të martesës me një shtetas italian bie në kundërshtim me normat e BE-së

të të japë dëbimin: në këtë rast mund të delegosh një person që të paraqesë denoncimin në vendin tënd

### NË KOMUNË, GJATË MARTESËS

Disa komuna kërkojnë për publikimin e martesës së përzier (midis një shtetasi italian apo të BE-së dhe një të huaji) paraqitjen e lejeqëndrimit, edhe pse kjo gjë nuk parashikohet nga ligji. Në të tilla raste shtetasi i huaj pa lejeqëndrim duhet të mundohet të mos paraqitet për të kërkuar publikimet.

Nëse këmbëngulin për të parë lejeqëndrimin mund të niset një proces gjyqësor për të shmangur publikimin e martesës (neni 100 i kodit civil) dhe të arrihet kështu menjëherë celebrimi i martesës, për shkak të të cilit, i huaji i parregullt nuk mund të dëbohet.

Dëbimi i shtetasit të huaj në momentin e celebrimit të martesës me një shtetas italian është në kundërshtim me normat e BE-së (sentenca e Gjykatës evropiane 25.7.08 C/217) dhe mund të paraqitet ankesë kundër tij.

apo kur duhet të zbatohet një urdher mbrojtjeje kautelare apo një urdher ndalimi apo heqje lirie (neni 352 i kodit penal);

2) policia gjyqësore (policia e shtetit, karabinierët, policia financiare, pyjore) mund të kontrollojë njerëzit, lokalet, makinat, bagazhet dhe sendet personale për të parandaluar, bllokuar trafikë droge (neni 103 dekreti presidencial nr. 309/1990) apo nëse ka arsye të justifikuar për prani armësh, municionesh apo eksplozivash, një të kërkuari nga policia që fshihet, një të arratisuri i dënuar për krime të caktuara të organizatave kriminale, trafik droge apo krime me qëllim terrorizmi neni 41 tuls

nuk je në gjendje të lexosh, ke të drejtë të marrësh një përkthyes dhe duhet të shkruhet gjithmonë se nuk e njeh italishten.

Kontrolli në një shtëpi apo në vende të mbyllura pranë saj nuk mund të bëhen para orës 7 dhe pas orës 20. Mund të kryhet jashtë këtij orari vetëm nëse ekziston një autorizim i shkruar i gjykatësit që duhet të ta tregojnë më parë. (neni 251 i kodit penal).

SHËNIM: paketa e sigurisë ka futur një masë të re që parashikon arrestimin nga gjashtë muaj deri në tre vjet "për këdo që me pagesë, për të përfutur padrejtësisht, strehon një të huaj pa leje qëndrimi, në një banesë që disponon,

## MBROJTJA LIGJORE

Përdorimi i paligjshëm/arbitrar i dhunës nga ana e policisë mund të denoncohet pranë autoriteteve gjyqësore penale. Në rast dhune, ndalimi e kontrolli të paligjshëm, veprime raciste nga ana e forcave të rendit, dhe të kontrolloreve të mjeteve të transportit, mund të paraqitet një denoncim pranë Prokurorisë së Republikës në vendin ku ka ndodhur veprimi.

Për veprimet që ndiqen vetëm nëse viktima denoncon (për shembull goditje, lëndime të lehta, fyerje, kërcënim etj.), denoncimi duhet të paraqitet gjatë tre muajve pas veprimit.

Denoncimi mund të paraqitet nga vetë viktima, këshillohet sidoqoftë prania e një ndihmësi ligjor, apo e shoqatave që ofrojnë ndihmë ligjore, edhe për të kundërshtuar kundër-denoncime të mundshme.

Kundër çfarëdolloj veprimi (edhe të karakterit normativ, si ligje shtetërore, rajonale, rregulla bashkiake, apo urdhra të kryetarit të bashkisë etj.) dhe sjellje që shkakton si pasojë trajtime të ndryshme në bazë të origjinës kombëtare, etnike, racore, e fetare, mund të propozohet veprimtaria civile kundër diskriminimeve etnike-racore.

Kur gjykatësi sigurohet se është duke u kryer një diskriminim, mund të dënojë dhe të dëmshpërblejë dëmet, edhe të llojit ekzistencial, që viktima ka pësuar. Në të tilla raste mund të drejtoheni pranë shoqatave që veprojnë në luftën kundër diskriminimit racor: ato mund të fillojnë këtë lloj procesi, qoftë në ndihmë të viktimave të diskriminimit qoftë kundër diskriminimit kolektiv.

Sue Ryder Care  
Albania



nëse në shtëpi,  
një i afërmi juaj ka një  
sëmundje të rëndë...

sot, edhe nga larg mund të besh diçka...

Mund të mbështesësh ekonomikisht  
Ryder Albanian, një shoqëri që ofron një  
shërbim asistencë domiciliare për të  
sëmuret me sëmundje në fazë të avancuar.

Dy ekipe të specializuara ofronjë në  
Tiranë dhe Durrës asistencë mjekësore,  
psikologjike dhe sociale falas për pacientët  
dhe familjarët e tyre.

**Jep kontributin tënd në:**

Sue Ryder Care Center - Albania  
Banka Amerikane e Shqipërisë

Në këto numra ligjorë të emri të Shoqatës  
"Ryder Albania"

30 46 393 1801 - EURO

10 407 31801 - ALL (Lek)

Në llogaritë bankare të tërësive në llogaritë  
taksore (18%) nëse do të hapet llogaritë.

c/c postale 23184005 intestato a:  
Associazione Ryder Italia  
Via del Nuoto, 11 - 00194 Roma

shkaku: "progetto Albania"

www.ryderitalia.it - email: ryderalb@cc-al.org

tel. +355 4 340352



Photo courtesy Luigi Morante

# GËZIM HAJDARI

## Murgu i poezisë shqipe në mërgim

**G**ëzim Hajdari është poeti shqiptar më i pranishëm antologjive botërore, më shumë se cilido shqiptar tjetër, duke qenë kështu edhe ndër më të studiuarit e letrave shqipe jashtë Shqipërisë. Por siç ndodh shpesh është pak i pranishëm e pak i ndjekur nga vet Shqipëria për të cilën ka bërë të flitet nëpër ambientet më elitare të poezisë botërore. Edhe pse paradoksale poeti me një talent të shpërthyer më së shumti e të mirëpritur tej mase jashtë Shqipërisë ka me vendin amë marrëdhënie të ndërlikuara e dyfaqëshe siç nuk mund të mos i kishte cilido idealist që për kohëra të gjata pat ëndërruar një Shqipëri më të mirë, duke varur shpresat në ndryshimet politike, sipas autorit të pam-

bërritura kurrë.

Por Shqipëria është e pranishme në vargun e tij të lirë, të thjeshtë, komunikues e të kapshëm, që nuk u ngjason aspak poetëve që me stile të padeshifrueshme duket sikur shkruajnë për të komunikuar vetëm me ndonjë koleg që ndan me ta të njëjtin kod shkrimi, minimalist, hipermetaforik, simbolist, surrealist, e çfarëdolloj figurash të tjera që eufimizojnë mendimet e hedhura në letër vrullshëm. Shqipëria e tij është e pranishme sepse nuk ka si të mos flasë për Shqipërinë, ku ka jetuar, por është një Shqipëri universaliste, e dhënë nga fshati i lindjes dhe më pas atdheu adoptues, Frosinone. Thënë kështu shumëkush mund të trembej përpara një letërsie rurale nga ato që i

Gëzim Hajdari është poeti shqiptar më i pranishëm antologjive botërore, më shumë se cilido shqiptar tjetër, duke qenë kështu edhe ndër më të studiuarit e letrave shqipe jashtë Shqipërisë. Por siç ndodh shpesh është pak i pranishëm e pak i ndjekur nga vet Shqipëria për të cilën ka bërë të flitet nëpër ambientet më elitare të poezisë botërore.

kish aq për zemër realizmi socialist, e që shkuan me kohë, por është krejt e kundërta, e këtij fenomeni, përmasat rurale janë të një universaliteti të pakrahasueshëm, që bën të reflektosh, për lidhjet e njeriut me kozmosin në një mënyrë të drejtpërdrejtë që bëjnë ta përjetojnë të gjitha shqisat. Pastaj ka akoma më shumë Shqipëri në stilin e poetit, që nëse profanëve mund t'u duket prozë e këputur vargësh, teknikëve nuk ka si të mos u bjerë në sy sensi epik, por jo ai patriotiku patetik që imiton rapsodët e lashtë, por ai që ka të bëjë me rëndësinë e fjalës, përshkrimin e drejtpërdrejtë dhe formësimin e marrëdhënieve njeri - natyrw, botë e jashtme, botë e brendshme, në një revijon në faqen 10





Vodafone One Nation 12

## Tani mjaftojnë 12 cent për t'u ndjerë pranë familjes

**Aktivizim falas gjatë promovimit për të gjithë klientët e rinj me parapagesë. Ofertë e vlefshme deri më 31 janar 2009.**

Aktivizoni Vodafone One Nation 12 dhe do të keni 500 minuta në muaj për të telefonuar drejt vendit tuaj me vetëm 12 cent në minutë. Ky opsion mund të aktivizohet në cilindo plan tarifor telefonik me parapagesë kundrejt pagesës prej 5 euro. Për më shumë informacion si dhe për t'u njohur me vendet për të cilat vlen ky plan tarifor, vizitoni faqen e internetit [www.vodafone.it](http://www.vodafone.it)

Tarifë për impulset e debituarë paraprakisht me kohëzgjatje prej 30 sekondash dhe me vlerë prej 6 cent. Impulsi në përgjigje 19 cent.

**Life is now**



**vodafone**

# GËZIM HAJDARI

## Murgu i poezisë shqipe në mërgim

vijon nga faqja 8

alitet i perceptuar i gjithi së brendshmi në mënyrë tri-përmasore.

Sepse tek e fundit edhe vetë autori është një teknik i letrave, përveç të qenit një farkëtar i zellshëm i poezisë. është një poet shqiptar që do të mbetet në historinë e poezisë shqipe por edhe një qytetar i botës, fakt ky që rrjedh jo vetëm nga dygjuhësia e tij por edhe nga pikëpamja antinacionaliste, dhe antipatetiste e tij. Një shkrimtar i tillë ka shumë ç't'i mësojë Ballkanit, dhe gjithë poetëve që u këndojnë shtetucëve me komplekse të mëdha psikologjike, që flasin për kufij të zgjeruar, popuj të bymyer, e lavdi të projektuara qiejve me shovinizëm. Por kanë ç'të mësojnë prej tij edhe poetucët e depressionuar të poezisë perëndimore që zvarriten turivarur mes dramave të përkohshme, e mikroskopike, që shuhën me një poezi njëminutëshe.

**ma.ru.**



**17 vjet poezi të Gëzim Hajdarit, botuar në vëllime të ndryshme poetike, janë përmbledhur së fundi në "Poesie scelte" botuar nga 'ControLuce'.**

**Antologjia me poezi të zgjedhura e sapodalë nga shtypi, është promovuar më 21 dhjetor në Milano e gjatë muajve në vazhdim do të paraqitet nëpër libraritë dhe universitetet italiane sipas një kalendarit që kalon në Perugia, Verona, Rovereto, etj. Libri mund të blehet pranë librarive më të rëndësishme italiane Feltrinelli, Mondadori, Rizzoli e të tjera..**



INTERVISTA  
nga Marjola Rukaj

**Si ka hyrë poezia në jetën tuaj, gjatë komunizmit, si e ka prituri regjimi atë?**

Kontakti im me poezinë lind që në moshën 11 vjeçe por është një histori shumë e gjatë që më është dashur ta përmbledh disa herë nëpër intervista. Ka nisur në fshatin ku unë kam lindur, në Hajdaraj, vazhdoi pastaj në gjimnaz ku edhe u konsolidua. Pastaj erdhi vëllimi i parë me poezi i quajtur "Antologjia e shiut" që del një muaj para rëzimit të diktaturës së Enver Hoxhës, natyrisht ka qenë një rrugëtim i mbushur me probleme politike, censure, mungesë lirie, që nuk ndryshuan as pas rënies së komunizmit. Edhe më pas kam pasur probleme të tilla e madje jam kërcënuar edhe me jetë.

Ne mbartim një kulturë, kulturën tonë, por duhet të jemi edhe shqiptarë edhe qytetarë të botës, mysafirë të botës. Duhet respektuar kufijtë tanë, atdheu ynë, por duhet dhe tejkaluar. Nuk do të hyjmë në familjen e madhe evropiane vetëm si shqiptarë por edhe si qytetarë të botës.

Unë gjithmonë bëja pjesë tek idealistët, besoja se do të ndryshonin shumë gjëra, se do të ndërtohej një Shqipëri e re më e ndershme më e ligjshme, më transparente, por nuk ndodhi asgjë e tillë. Si gjithmonë idealistët janë humbësit e mëdhenj. Edhe në këtë rast fituan po ata që ishin fitimtarët e mëparshëm, ata që ishin ideologët e regjimit. Ndërsa pjesës më të lodhur më të vuajtur të vendit iu desh të largohej. Edhe sot mbeten po të njëjtat kushte. Në Shqipëri nuk ka ndryshime. Një pjesë e mirë e idealistëve u detyruan të iknin, dhe Shqipëria mbeti e njëjta që ishte. Kjo natyrisht nuk do të thotë se ne kemi ndërprerë lidhjet me Shqipërinë. Tek Poema e mërgimit (Poema dell'esilio), shpjegoj gjithë këtë situatë. Aty flas për gjithë dështimet e mia në marrëdhënie me Shqipërinë

dhe dështimet e Shqipërisë me veten dhe të ardhmen.

**Çfarë përmbante "Antologjia e shiut", botuar në fund të viteve '80?**

E kisha përmbledhur në '85 por nuk ishte e mundur të botohej sepse nuk përmbante vjersha që t'i këndonin jehonës e lavdisë së partisë, rolit të partisë, socializmit etj. Për të ma botuar kërkoni që unë të bëja jo pak ndryshime. As titulli nuk ishte i përshtatshëm sipas drejtorit të shtëpisë botuese Naim Frashëri, sepse simbolizonte Antologjinë e lotëve, dhe binte në kundërshtim me fitoret e partisë komuniste dhe të socializmit në Shqipëri që nuk kishte si të pranonte pesimizëm e lot. Prandaj u arrit të botohej vetëm pak kohë para rënies përfundimtare të diktaturës. Pastaj u botua në Itali, dhe së shpejti do të botohet sërish i pacensuruar në Shqipëri.

**Si ndodhi që më pas u transferuat në Itali?**

Kjo është një pyetje që ma bëjnë shumë gazetarë shqiptarë por pastaj në përgjithësi nuk e botojnë përgjigjen, nuk e di pse, madje e censurojnë edhe kur botojnë intervista të miat të botuara në shtypin italian. Unë erdha në Itali në '93, pasi isha i kërcënuar për vdekje në Shqipëri. Merresha me politikë isha kryetar i partisë republikane, në Lushnjë, dhe madje isha kandidat për deputet në '92, isha ndër 4-5 republikanët e parë në Shqipëri. Shkruaja në gazetën Republika, ku denoncoja krimet e politikës në Shqipëri, por edhe shpërdorimet e regjimit paskomunist shqiptar. Kështu ika i zhgënjyer, nga një Shqipëri që nuk arriti të bënte ndryshime radikale. Për mendimin tim do të duhen 50 vjet që Shqipëria të arrijë stadin e zhvillimit që duhet. Në 18 vjet pas komunizëm politik shqiptarë nuk ka pasur interes të ndryshojë këtë situatë. E drejton e njëjta klasë politike, ata që dje dënuan, burgosën, varën, ata janë të njëjtët që drejtojnë edhe sot. Sot janë deputetë ministra, ambasadorë, atashë kulturorë. Utopia e socializmit real sot quhet demokraci. Duhet të nxirret një ligj, që gjithë elita e




Photo courtesy Daniela Teggi

njëherë e një kohe, nuk duhet të jetë më e pranishme në jetën politike shqiptare, duke përfshirë që nga funksionarët e burokratët e lartë, deri tek ata në rrethe, gjithë ç'përbante nomenklatura e gjerë e partisë. Duhet të vijë brezi i ri, ndryshe Shqipëria nuk ka si të ndryshojë. Edhe pse kanë kaluar pothuaj 20 vjet nuk shihet brezi i ri në skenë, nuk janë kthyer. Për pasojë nuk ka ardhur mentaliteti i ri.

**Megjithë zhgënjimin tuaj të madh ka shumë Shqipëri në poezitë tuaja...**

Po patjetër, ndryshe nga ç'thonë nganjëherë gazetaret poezia ime nuk është italiane, por është një ndërthurje kulturash ashtu siç bënin tek e fundit edhe humanistët e mëd-

henj. Shqipëria bën pjesë tek unë sepse bën pjesë në trupin tim, në trurin tim, në fjalën time. Por kjo nuk duhet ngatërruar me të qenin nacionalist. Unë nuk jam nacionalist dhe njeriu nuk duhet të jetë nacionalist. Ne mbartim një kulturë, kulturën tonë, por duhet të jemi edhe shqiptarë edhe qytetarë të botës, mysafirë të botës. Duhet respektuar kufijtë tanë, atdheu ynë, por duhet dhe tejkaluar. Nuk do të hyjmë në familjen e madhe evropiane vetëm si shqiptarë por edhe si qytetarë të botës.

**Çfarë do të thotë sot Shqipëria për ju?**

Shqipëria për mua vazhdon të jetë atdheu im që vazhdon të masakrohet edhe pse kanë kaluar pothuaj 20 vjet nga rë-

Unë erdha në Itali në '93, pasi isha i kërcënuar për vdekje në Shqipëri. Merresha me politikë isha kryetar i partisë republikane, në Lushnjë, dhe madje isha kandidat për deputet në '92, isha ndër 4-5 republikanët e parë në Shqipëri. Shkruaja në gazetën Republika, ku denoncoja krimet e politikës në Shqipëri, por edhe shpërdorimet e regjimit paskomunist shqiptar. Kështu ika i zhgënjyer.

nia e bustit të Enver Hoxhës. Vazhdon të poshtërohet, vazhdon të jetë vendi më i korruptuar në Evropë, i keqpërdorur nga një klasë politike më se e korruptuar.

**Por Shqipëria në poezitë tuaja perceptohet në një mënyrë shumë universaliste, nëpërmjet Darsisë, fshatit ku keni lindur, natyrës shumë të gjallë në gjithë elementet e saj... Janë edhe elemente origjinale, që rrallë ndeshen në poezinë shqiptare, të një Shqipërie rurale, por jo të mangët, e as provinciale...**

Këto janë simbole, pjesë të vendit tim por që e shndërron në një temë universale, të lidhjes me atdheun, me rrënjët

vijon nga faqja 11

e veta, në lidhjen emocionale me vendin ku kam kaluar një pjesë të mirë të jetës sime. Për sa i përket elementëve të natyrës synimi im ka qenë të rikuperoj elementët mistikë këtij mesazhi të madh të lidhjes mes nesh dhe kozmosit, mes nesh dhe natyrës. Është një element shumë tërheqës që e kam zbuluar tek mistikët arabë. Unë i kam kushtuar jetën studimit, dhe udhëtimit, është një përkushtim i plotë. Është e vështirë që kjo të kuptohet nga shtypi shqiptar që është ende i burgosur nga dogmat e realizmit socialist. Duhet shkruar për ata që vijnë pas vdekjes, për ata që vijnë pas 100 200 vjetësh, duhen vite që të kuptohet këto lloj gjërash. Nuk është e lehtë sot që në një botë frenetike, materialiste si kjo e sotmja, një poet të përbushë misionin e vetë. Poeti nuk duhet të ulet e të shkruajë për problemet e tij të vogla. Një nga misionet e mia është rikuperimi i misionit të poetit, që duhet edhe të çojë përpara manifestin letrar, dhe sensin jetik e muzikor të fjalës poetike. Deri dje poeti ishte zëdhënës i një epoke, kurse sot poezia perëndimore u këndon fobive, gjërave të vogla. E njëjta gjë vlen edhe në Shqipëri, ku pothuaj nuk ka fare poetë.

### Ju e ndiqni poezinë shqipe rregullisht?

Po pa tjetër, e ndjek me kujdes edhe sepse shpesh më ndodh të jap leksione për poezinë shqipe. Është shpejt të jepen patenta, koha do të tregojë e do të përzgjedhë.

**Poezia shqiptare ka një prurje të jashtëzakonshme, janë me qindra autorët e rinj shqiptarë që botojnë kryesisht poezi, ju e ndiqni këtë fenomen?**

Nuk besoj se mund të shkruhet poezi duke lindur e duke vdekur në Tiranë, duke shëtitur nga një pallat, në tjetrin, nga liqeni tek godina e qeverisë... Poezia duhet të zhvishet nga lidhjet nacionale dhe të ikë në udhëtimit, të kapërcejë kufizimet që sjell përmasa nacionale. Kohët duhet të sjellin të tjera prurje. Por është vështirë të vlerësohen kaq shpejt poetët shqiptarë. Për momentin vitet e gjata të komunizmit kanë lënë gjurmën e vet negative dhe

# GËZIM HAJDARI

## MURGU I POEZISË SHQIPE NË MËRGMIM




Photo courtesy Luigi Morante

Ta quash veten poet migrues është nder i madh, është privilegj, sepse do të thotë të të barazojnë me Baricco-n dhe të tjerët. Është një nder i madh sepse gjithë mistikët e poetët më të mëdhenj kanë qenë të gjithë migrues. Kanë qenë të tillë sepse çliroheshin, nga kombësia, arrinin përmasa të tjera, vlera universale, përndryshe do të mbeteshin provinciale.

është e vështirë që të zhbëhet. Fakti është që asnjë poet shqiptar nuk bën pjesë në fondin evropian. Ku janë poetët e mëdhenj shqiptarë? Ka djem dhe vajza që mundohen të shkruajnë diçka, në emër të modernizmit. Dhe gazetaret shqiptarë, që janë pasqyrim i jetës politike e kulturore shqiptare, vazhdojnë të bëjnë jehonë në atë gjullurdinë e përgjithshme që ka kapluar Shqipërinë në vitet e fundit. Përshtatimet janë të pakta.

**Çfarë doni të thoni kur denonconi faktin se në Shqipëri ende janë të vlefshme parimet e realizmit socialist? Në vitet e**

**fundit kanë qenë të panumërta përpjekjet e vlefshme e të pavlefshme për t'iu rebeluar realizmit socialist...**

Në Shqipëri, ose më mirë të them edhe gazetaret jashtë Shqipërisë vazhdojnë të na servirin pseudo-mitet e realizmit socialist si simbolet e letërsisë moderne shqiptare. Vazhdojnë të na i paraqesin madje shumë autorë si mbrojtës të të drejtave të njeriut, ndërsa është fakt që e dinë të gjithë se bëhet fjalë për ata që deri dje u kanë thurur poemat më madhështore luftës së klasave, kanë qenë artistë të



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

## Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizimi falas për të gjithë klientët e rinj deri më 8 shkurt 2009.

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione [www.wind.it](http://www.wind.it)



**WIND**

vijon nga faqja 12

Enver Hoxhës, dhe nuk kanë bërë asgjë kundër luftës së klasave. 146 intelektualë janë vrarë në emër të atij regjimi. Artistët e Hoxhës, në të mirë apo në të keq hynë në histori, duhet të historizohen por nuk duhet të përdoren akoma si vlera absolute sepse kështu denigrohet kultura shqiptare dhe prurjet e reja. Si të thuash ka rënë diktatura por është ende gjallë kultura e regjimit. Por kjo nuk është një temë me të cilën mund të merrem tani sepse e kam trajtuar në librin tim më të ri dhe atje është e sqaruar ashtu siç e mendoj. Poetët e Tiranës janë njerëz me pushtet, dhe vazhdojnë të jenë poetë oborresh. Deri dje ishin në shërbim të politikës dhe sot janë po ashtu ministra e deputetë.

**Në poezitë tuaja del shpesh herë ankesa e harrimit nga Shqipëria, e thënë më hapur, kjo do të thotë që Shqipëria nuk tregon kujdes për letërsinë shqipe të shkruar jashtë?**

Po, sepse unë nuk i kam kënduar Shqipërisë, ajo Shqipëri për të cilën kam kënduar unë është diçka mitike, ashtu siç do të doja unë të ishte. Siç edhe e ëndëronin humanistët shqiptarë. E kam fjalën për Shqipërinë e ligjshme, të fjalës së lirë, Shqipërinë demokratike të njerëzve të ndershëm, që respektojnë njeriun dhe vlerat e vërteta. Shqipëria nuk ka si të tregojë kujdes për ne. Shqipërinë në përgjithësi e kanë bërë migruesit, ata që kanë jetuar në mërgim. Ata që kanë lindur në Tiranë i kanë kënduar vetëm Tiranës dhe nuk kanë nxjerrë asgjë të madhe nga kjo.

**Si shpjegohet një fenomen i tillë, ndërsa është krijuar tashmë një kontingjent shkrimtarësh që nuk mund të shpërfillet, dhe që bëjnë që të flitet mirë për Shqipërinë jashtë saj?**

Kjo ndodh sepse kultura në Shqipëri manipulohet nga pushtetarët. Vetë poetët janë vetë pushtetarë. Në asnjë vend të botës nuk ndodh që poetët të jenë pushtetarë ashtu siç ndodh në Shqipëri. Poeti duhet të rrijë larg dhe duhet të ketë një sens kritik ndaj botës që e rrethon sepse nuk mund të mos synojë një botë më humane, më të drejtë, ndërsa poetët tanë në të vërtetë janë



### **da Poema dell'esilio / Poema e mërgimit**

di Gezim Hajdari

*La mia unica colpa è stata di non aver accettato compromessi, denunciando gli abusi e i crimini del vecchio regime e quelli del nuovo regime di Berisha sulla stampa locale e nazionale.*

*È per questo che mi sento felice in esilio, amici miei. Pochi, come me, hanno denunciato pubblicamente con onestà e coraggio i servitori di ieri e di oggi.*

*Quando festeggiarono l'anniversario della "Democrazia", nel palazzo della cultura a Lushnje, non accennarono mai al mio contributo.*

*È per questo che mi intristisco in esilio, amici miei.*

*Nella sede del Partito Democratico di Lushnje, un suo militante mi ha colpito buttandomi a terra perché avevo scritto sul giornale, che i suoi, durante la dittatura,*

*avevano torturato gente innocente.*

*È per questo che mi rabbuio in esilio, amici miei.*

*Nel "Bar Blerimi", a Lushnje, il figlio di un direttore "democratico", criticato da me sul settimanale «Ora e fjalës», mi ha colpito in mezzo alla gente mentre stavo per prendere un caffè.*

*Non era la prima volta che venivo aggredito.*

*È per questo che vivo in esilio, amici miei.*

*Nella sede del Partito Repubblicano, nel quale ero segretario per la provincia di Lushnje, spararono. Fu una vera minaccia.*

*Avevamo perso. Non c'era più posto per me in patria.*

*Sono fuggito sconfitto e disperato.*

*È per questo che vago nell'esilio, amici miei.*

*Gli "amici del Partito democratico" della città di Lushnje, dopo la mia fuga, presero l'appartamento fatto di una stanza,*

*una cucina e un bagno, dove abitavo e lo vendettero,*

*mettendo per strada i miei genitori e migliaia di volumi di libri.*

*È per questo che grido in esilio, amici miei.*

## GËZIM HAJDARI

cinikë. Dhe mbi të gjitha nuk ka kritikë, nuk ka lindur akoma kritika. Është një vend shumë provincial, i papërfillshëm. Mjafton të shikohet sa pak e pranishme është Shqipëria e Tiranës në libraritë e Evropës.

**Shpesh herë ju cilësoheni si një poet migrues. E ndjeni për shtat këtë fjalë apo ju duket një kategorizim zvogëlues?**

Po patjetër. Ta quash veten poet migrues është nder i madh, është privilegj, sepse do të thotë të të barazojnë me Baricco-n dhe të tjerët. Është një nder i madh sepse gjithë mistikët e poetët më të mëdhenj kanë qenë të gjithë migrues. Kanë qenë të tillë sepse çliroheshin, nga kombësia, arinin përmasa të tjera, vlera universale, përndryshe do të mbeteshin provincialë. Kjo nuk arrihet të kuptohet në Shqipëri. Njerëzit e quajnë veten shkrimtarë sepse kanë bërë dy libërtha e ca poezi, ndërkohë që të jesh shkrimtar e poet do të thotë të njohësh botën, të tejkalosh përmasat dhe kufizimet e ambientit prej nga vjen. Duhet të njohësh filozofinë, teologjinë, letërsinë. Nuk ka pse mos të të pëlqejë përkufizimi migrues, sepse kjo do të thotë se je shqiptar por je edhe mysafir i botës, është diçka tejet pozitive. Poezia migruese është poezi që lëviz, që transformohet, është shqiptare, por edhe universale, i përket botës, jo vetëm Shqipërisë, pra nuk ka si të mos jetë plot me botë. Është një titull që duhet fituar, jo kushdo mund të jetë i tillë, sepse do të thotë të krijosh vlera, të krijosh një poezi që u flet popujve të ndryshëm, që u mëson artin e dialogut popujve, që u mëson të gjithëve të jenë të huaj dhe migrues në botë, për tu kuptuar.

Shpesh herë përkufizimin "shkrimtarë migrues" shqiptarët që shkruajnë në gjuhë të tjera e cilësojnë si getizim, kategorizim zhvlerësues, etj...

Janë të rinj dhe duhet kohë për të arritur këtë përmasa. Përpara se të arsyetojnë në këtë prizëm duhet të studiojnë, të hulumtojnë, e të çojnë

përpara manifestin letrar, nuk është diçka e thjeshtë. Në një demokraci të gjithë mund të flasin por jo të gjithë vlejné. Kjo është një temë shumë interesante për mua sepse kam studiuar letërsi krahasuese.

**Si jetoni me dy-gjuhësinë? Kur keni filluar të shkruani italisht?**

Kam filluar të shkruaj që në vitin 1993, me librin tim të dytë "Ombra di cane". Të shkruash në dy gjuhë është një stimul, është një çlirim përfundimtar, do të thotë të matesh me botën, por të mos harrosh as gjuhën e nënës, atë që Dante quante "il parlare materno", gjuhën e dashurisë. Për mua ka qenë një sakrificë mbinjerëzore, i detyruar të braktis vendin tim, duke përballuar punët më masakruese. Pastaj të vazhdosh studimet universitare, të shkruash edhe shqip edhe italisht, dhe të përpiqesh të krijosh vlera të mëdha, të mbijetosh, e për më tepër të përballosh imazhin e keq të vendit tënd, në mungesë të shtetit tënd... Megjithatë me përkushtim ia dilet. Ka qenë edhe një arsye pragmatike. Në Itali jetojnë 500 mijë shqiptarë por askush nuk blen librat e mi, lexuesit e mi janë evropianë, janë nga vende të ndryshme të botës, por nuk janë shqiptarë. Kështu kjo ka qenë një nevojë e natyrshme për lexues. Librat e parë i kam botuar me paratë e mia sepse nuk kisha lexues. Brezi i parë i migruarëve shqiptarë ishte i detyruar t'i përkushtohej nevojës për mbijetesë, nuk kishte kohë për kulturë. Brezi i dytë e i tretë, natyrisht do të kthehet pastaj tek identiteti, tek kultura. Një faj të madh e ka mungesa e një instituti kulture shqiptare, mungesa e politikave kulturore të shtetit shqiptar, detyrimisht lexuesi shqiptar duhej të kultivohej e promohej nga shteti. Kështu poetit shqiptar i duhet të përpiqet në mënyrë mbinjerëzore i vetëm.

**Ç'pasoja kanë pasur tek ju marrëdhëniet me atdhetë tuaj - të themi - Italinë, me imazhin e saj të keq për shqiptarët, dhe Shqipërinë me nacional-provincializmin e saj?**

Në të tilla kushte është e vështirë dhe unë mendoj se brezit tim i ra fati më i keq. Me kalimin e viteve kuptohet gjërat do të ndryshojnë pak nga pak. Kurse nacionalizmi, ai

”

Të shkruash në dy gjuhë është një stimul, është një çlirim përfundimtar, do të thotë të matesh me botën, por të mos harrosh as gjuhën e nënës, atë që Dante quante "il parlare materno", gjuhën e dashurisë. Për mua ka qenë një sakrificë mbinjerëzore, i detyruar të braktis vendin tim, duke përballuar punët më masakruese.

e pozitiv për të gjithë.

**Ku shihet ky lloj nacionalizmi në kulturën shqiptare?**

Kur unë kam filluar të shkruaj edhe shqip edhe italisht, ka pasur shumë reagime nga kolegë të mi, nga njerëz që përfaqësonin kulturën shqiptare, por edhe nga shtypi shqiptar, të cilët shpesh herë më kanë cilësuar si tradhtar, dhe armik të kulturës shqiptare. Kanë qenë vështirësi të tmerrshme. Duhet edhe edukuar njerëzit e kulturës shqiptare. Ballkani është vendi ku kanë lindur perënditë, mitet, një vend fatalist, i despotëve, i diktatorëve, i mistereve. Kështu Ballkani vuan nga sëmundja foshnjore e nacionalizmit por më shumë se gjetkë vuan Shqipëria sepse Shqipëria ka qenë e mbyllur për pothuaj 50

**Stili juaj i të shkruarit është disi i veçantë, vargjet e lira që ngjasojnë me prozën. Si ka ardhur ky lloj stili, cilët kanë qenë shembujt tuaj letrarë?**

Baza e stilit tim ka qenë dhe vazhdon të mbetet epika shqiptare, në kuptim që epikët shqiptarë përshkruanin çdo gjë në mënyrë të drejtpërdrejtë, i jepnin rëndësi fjalës jo figuracionit. Kjo i jepte poezisë epikë. Kuptohet kjo nuk duhet ngatërruar me nacionalizmin që përcillnin rapsodët, sepse ato janë regjistruar në kohën kur luftohej për mbijetesën e kombit shqiptar. Unë kërkoj të zgjedh epikën si alternativë të poezisë minimaliste, bashkëkohore. Në stilin e veprës sime poetike pastaj kuptohet ndërthuren shumë elemente si epika shqiptare, tradita orientale, ajo perëndi-



G. Hajdari me Prof. Laura Toppan e universitetit francez Nancy 2, e cila ka shkruar një sërë studimesh mbi poezinë e Hajdarit. Photo courtesy Luigi Morante

komb-formues, ka perënduar dhe e ka bërë të vetën me kohë, kjo që mbetet tani është thjesht diçka patetike, që i vë njerëzit të jenë njëri kundër tjetrit. Është një pengesë që nuk lejon integrim në familjen evropiane. Është diçka që nuk sjell asgjë të mirë as për ekonominë, as për kulturën. Kufijtë dhe flamurët duhen respektuar por edhe duhet të tejkalohen për tu integruar në një identitet më të gjerë dhe më paqësor, tolerant,

vjet. Të tjerët, kanë pasur marrëdhënie të mira me pjesën tjetër të Evropës. Kurse në Shqipëri është e tmerrshme, sepse elitave u ka leverdisur, ta kontrollojnë nëpërmjet nacionalizmit. Dhe kështu Shqipëria ka një nacionalizëm të tmerrshëm. Edhe sot mungon një politikë largpamëse në lidhje me kulturën.

more natyrisht, e mistikëve arabë, etj. Ndosht shpesh një gabim i madh me poetët shqiptarë, ata që jetojnë në Itali shkruajnë si italianët, ata që jetojnë në Francë shkruajnë si francezët. Ky është gabim, një poet shqiptar kudo qoftë duhet të këndoje si ballkanas e si shqiptar, me një farë shkrirje traditash, por duhet të mbesë karakteri.

*Bisedoi Marjola Rukaj*

nga Ilirjana Stringa  
Bota Shqiptare nr 88, korrik 2003

**M**pret tek stacioni i trenit dhe unë që nuk e kam njohur, sepse kam parë vetëm një fotografi të tijën, prej së cilës kam menduar se duhet të ishte trupmadh, pothuaj zhgënjehem tek e kuptoj se Gëzim Hajdari është ai burri i hajthëm që shtrëngon në njërën dorë një gazetë dhe me tjetrën lëmon mjekrën. Kam paragjykimet e mia mbi poetët, dhe ata me siguri i kanë mbi mua, sepse matemi me sy krejt hapur dhe heshtim në pjesën e parë të rrugës. Gëzimi banon në Frozinone, rreth një orë me tren nga Roma. Për të mbërritur në shtëpinë e tij, në qendrën historike të qytetit - "duhet të shohësh ku banon poeti", pat këmbëngulur në telefon, - marrim një

taksi. Pjesa tjetër, një malore që të merr shpirtin, e bëjmë në këmbë dhe unë detyrohem t'u buzëqesh të gjithëve, që na përshëndesin "Mirëdita profesor, si jeni?", "Profesor...". Edhe para shtëpisë, punëtorët që riparojnë një fasadë të palatit, recitojnë të njëjtin refren: "Buongiorno Professore, come sta?". Kemi nisur të flasim për politikë dhe gazeta, dhe fillimisht më duket sikur ma hedh fajin mua dhe "Botës Shqiptare" për imazhin e shqiptarëve në Itali. "Kur dal përpara studentëve, më duhet të përballim me provokime. Në vend të mendoj për letërsinë, më duhet të shqetësohem si t'i përgjigjem mbi ato që bëjnë shqiptarët." Kam nisur të pendohem që erdha deri këtu, "poetët janë të gjithë njëjloj" dhe "këtë shkrim mund ta kisha bërë fare mirë me telefon", i them vetes, por tani është vonë. Kemi hyrë në shtëpi dhe më duhet të përqëndrohem në kornizat që mbulojnë muret. Janë çertifikata çmimesh letrare, portrete të Gëzimit, vizatime e piktura të përmasave të mesme. Ky është korridor, por edhe në dhomën e ndenjes në mure s'ka më vend për çmime të tjera. Ulemi përballë, në pozicion kundërshtarësh dhe kam përshtypjen e vagullt se tashmë ma ka vënë notën. Për "poetin" unë

PESE VJET MË PARË NË BOTA SHQIPTARE

## Gëzim Hajdari UDHËTIM NË SHTËPINË E POETIT


**Pesë vjet më parë "Bota shqiptare" zbriste në shtëpinë e poetit në Frozinone. I rilexuar sot, reportazhi sjell po atë poet, të rritur në poezi, por koherent në bindjet e veta mbi jetën, poezinë dhe.. atdhetë.**

jam "një gazetarkë". Mendohej të shquaj nga ku jam ulur titujt e librave që mban biblioteka e tij, kështu t'ia vë notën edhe unë dhe të iki. Prespektiva e një dite në Frozinone me një poet që ka zakonin e Lasgush Poradecit tek "Ftesë në studio" dhe shkruan për tokën dhe fshatin si Shimus Hini, më ngjan e padurueshme.

Kur patriotët e pyesin pse shkruan italisht

Por Hajdari më duket se e ka

kuptuar, sepse papritur ndryshon nuancat e zërit dhe nis të flasë për shkrimtarët që shkruajnë në dy gjuhë njëherësh dhe për marrëdhëniet mes kulturave të ndryshme. Përmend Kunderën që shkruan frëngjisht tashmë, Çezllav Milloshin që shkruan anglisht dhe papritur kalon tek atdhetaria. E shqetëson nacionalizmi patetik, është kundër "Shqipërisë së madhe", siç është kundër "Serbisë së madhe", përmend shkëmbimin mes kulturave



greke dhe latine, lëvizjet e kulturave në Europën moderne dhe ankohet për anakronizmin shqiptar që "si shfaqje të një tjetër shekulli" po na lë jashtë nga pjesa tjetër e botës. "Trupi im është atdheu im", thekson, "unë kam lindur në Shqipëri dhe kam ardhur në Itali. Jam shqiptar, por shkruaj italisht. Jam shqiptar, por trupi im është këtu... Si poet krijoj çdo ditë një atdhe të ri, duke dalë e duke hyrë nga një gjuhë në tjetrën. Duhet t'u mësojmë të gjithëve të jenë të huaj dhe migrantë. Objektivi nuk është integrimi, që rrezikon të shkatërrojë dallimet kulturore, por ndërveprimi, pasurimi, shkëmbimi mes kulturave"

Ka zë të thellë dhe të folur pothuaj hipnotike. Flet një italisht të pastër, përzier herë-herë me një shqipë të pastër. Nja dy herë më përsërit se nuk ndjehet fort mirë dhe se javën e shkuar ka qenë në Romë për të takuar dy studentë që kanë zgjedhur si temë diplome poezinë e tij. Ah po, poezia e Gëzim Hajdarit.

### Nga vjen poezia

Librin e parë e ka botuar në Shqipëri në vitin '90. Titullohet "Antologjia e shiut" dhe ka kaluar mjaft kohë nëpër sirtarë redaktorësh e recensuesisht që nuk i gjenin fillin titullit "pak socialist". Të gjithë librat e tjerë i ka botuar këtu. Erbamara, Ombra di cane, Sassi controvento, Corpo presente, Stigmati, janë libra me poezi dygjuhëshe. Kur nuk i shkruan drejtpërdrejt në italisht, Hajdari i përkthen vetë poezitë e tij. "Më shumë i rikrijoi sesa i përkthej", thotë. Kritika e ka marrë "me sy të mirë" (natyrisht jo pa arsye), i gjenjë përngjashmëri dhe Ungaretin dhe Bodlerin dhe i kujtojnë ngjyrimet e pashmangshme balkanike. "Më shumë se ngjashmëri me Ungaretin, unë do t'i quaja pika takimi, ose më mirë një vazhdimësi të traditës ungare-tiane, - shpjegohet. - Jam përpjekur të nisem nga ku ai është ndalur... Prek temat e kënetës ekzistenciale bodleriane, por duke shkruar në një tjetër drejtim. Magjia e mëkatit dhe e satanizmit, më torturon dhe më tërheq, ashtu siç tërhiqte të gjithë "poetët e mallkuar" francezë. Jam një i mërguar në trupin tim, por rrugëtimi im nuk ka vdekjen si të vërtetë të fundme, - sepse poeti e sjell sa është gjallë përmasën e vdekjes, - por të ardhmen, nëse do ta kemi natyrisht. Vdekja ime të të jetuarit ndryshe, ringjallja. Dhimbja e Ballkanit sjell në vete ndjesinë e fatit dhe të fatalitetit. Ballkani prodhon më shumë dhimbje nga sa mund të harxhojë."



*abonohu në*  
**Bota shqiptare**  
GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetmi zë në gjuhën shqipe në shtypin italian  
"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali  
"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.  
"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

**PAJTOHU PËR VETE**  
*apo për t'ia bërë dhuratë një mikui*

abonimi për një vit (22 numra)

**€ 35.00**

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT  
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE  
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese  
në llogarinë postare (conto corrente postale)  
nr. 16831018 në favor të BOTA SHOIPTARE

Telefoni në redaksi dhe kërkoni të të nisim numrin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.  
Me ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.



vijon nga faqja 17

Poezia e tij e librave të parë të kujton një përzjerje të poezisë së Kadaresë, Agollit dhe brezit tjetër të poetëve, Spahiut, Londos. Më pas natyrisht ndikimet nga leximet e mëtejshme dhe sidomos ndikimet nga strukturat e një gjuhe tjetër, e shpien tjetërkund. Nga Erbamara tek *Corpo presente*, ndryshimi është i dukshëm. Lirizmit dhe verizmit të librit të parë i zë vendin një qasje më metafizike, ndërthurur me një prekje të lehtë, që të kujton paksa haikun japonez.

Përveç librave poezitë e tij i gjen edhe në dhjetra antologji, përveçse ato studiohen në kurset pasuniversitare për Master në universitetet e Roma 3, La Sapienza, në Universitetin e Bolonjës, në Harvard University, Warwick dhe Birmingham. Poezia e tij është përkthyer në anglisht, greqisht dhe gjermanisht.

### Rrënjët e poetit

Në poezinë e Gëzimit ndjehet e fortë prania e natyrës. Nga një dritare e pallatit më tregon me krenari pamjen që shtrihet prej aty. Kodrat dhe pemët përreth Frozinones i kujtojnë paisazhet e fëmijërisë në Hajdaraj të Lushnjes. Nga mënyra sesi më flet për ta edhe prindërit duket sikur kanë mbetur pjesë e po kësaj fëmijërie. Së shpejti do t'i marrë aty, në shtëpi. "Janë të sëmurë, - shpjegon. - Ime më s'e ka marrë vesh kurrë se me ç'merrem. Ndërsa im atë është lexues i madh." Historia "e jetës së tij të dytë", që nis në prill të '92, këtu në Itali, është e trishtuar. Duket i tunduar të ankohet për çfarë ka kaluar në këto vite, por më duhet të shfletoj gazetën e Çoçarisë për të kuptuar sa të vështirë duhet ta ketë patur jetën Hajdari. Në Shqipëri i ka bërë të gjitha, nga punëtor në një ndër-marrje bonifikimesh, ekonomist, magazinier, roje fushe, i papunë, deri ditën kur i dhanë të drejtën për të studiuar letërsi në Elbasan. Gjatë qeverisjes së Berishës, është ndër themeluesit e Partisë Republikane dhe për pak kohë bashkëpunon me gazetën "Republika". Pjesëmarrja e poetit në politikë arrin kulmin në 1992 kur kandidon si përfaqësues i PR-së në një zonë me Tritan Shehun. Justifikohet duke thënë se asokohe atdheu kërkonte kontributin e të gjithëve, dhe ai donte të jepte të vetin. Zhgënjimi politik arrin deri aty sa në 1992 largohet nga Shqipëria për të kërkuar statusin e "emigrantit politik" në Itali, status që nuk ia japin asnjëherë, sepse Shqipëria konsiderohej

**Shqipëri,**  
ç' pikëllim fati ynë  
humbim çdo ditë njëri-tjetrin  
ç'mashtrim të jem banori yt  
e ti balta ime  
vdesim çdo ditë njëri tek tjetri

Do të më gjejnë  
në hamullore  
pa frymë në buzë  
shtrirë mbi kashtën  
që adhuroj  
e pëllumba kullosin për qark

Mbi fytyrë napa e bardhë e  
sime mëje  
do të më shpien  
në dhomën ku linda  
"I gjori djalosh  
sa ka vuajtur!"  
do të përshpërijnë  
reth kufomës sime

Pasi do të më kenë larë  
me ujin e freskët të pusit  
do të më vendosin mbi qerren  
e grurit  
tërhequr nga buajt

Do të përshkoj  
për herë të fundit  
rrugën ku rendja në fëmijëri  
nëse do të jetë muzg  
xixëllonjat do ndriçojnë  
vendqëndrimin e ri

**nga Barihidhur  
(Erbamara)**

**Kudo që shkoj në Perëndim**

sjell me vete fytyrën timë të  
gërryer

në sytë e mi të trishtë  
si në një burg:  
Shqipëria ime, zëra të humbur  
e ti që lagësh nën të tjerë  
shira

Ndoshta në një ditë me shi  
do të vdes edhe unë, në  
rrugë

vrarë nga gurët e mi  
qëlluar kundër erës

Megjithatë do të kthehen  
për të ndarë  
të gjallët ng atë vdekurit  
e të lirojnë ëndrrat e marra  
nën gurë  
me mundim.

(nga *Corpo presente*)

# Gëzim Hajdari

## UDHËTIM NË SHTËPINË E POETIT



tashmë një vend demokratik. Tashmë politika nuk bën më pjesë në jetën e Gëzimit.

duket mjaft e pastër për një 46-vjeçar që jeton i vetëm dhe me pak të ardhura.

### Atdheu i dytë

Frozinone i dha një punë si tipograf. Punonte nga dhjetë orë në ditë dhe tregon se ishte i lumtur kur gjente kohë të shkruante diçka. Me këmbëngulje regjistrohet në universitetin e La Sapienza-s në Romë, për të studiuar Letërsi moderne. Dhe pastaj vijnë librat, njëri pas tjetrit. Të botosh poezi në Itali, është po aq e vështirë sa t'i botosh në Shqipëri, ndaj edhe Hajdari i ka publikuar fillimisht librat e tij me paratë e djersës së vet. Këmbënguljen dhe durimin duhet t'i ketë patur pa kufi, derisa sot, kur i kërkoj në ka fotokopje gazetash a revistash që kanë shkruar mbi poezinë e tij, më vë përpara një tog që s'mbaron. Paçka se me shtrëngesa, ia del të jetojë me ligjëratat që mban herë pas here në Universitet, me artikuj e përkthime, apo lexime poezish.

Përveçse i vlerësuar me dhjetra çmime në konkurse kombëtare e ndërkombëtare poezie, Gëzim Hajdari është edhe qytetar nderi i Frozinones. Jeton në një shtëpi me qera, që ia ka dhënë bashkia e qytetit "për merita letrare", nuk ka televizor dhe me sa tregon dëgjon vetëm pak muzikë klasike. Ka një kompjuter të vjetër për të punuar dhe me një krenari të dëshpëruar më tregon se më së fundi ka blerë një lavatrice, ndërsa për vite me radhë rrobat i ka larë me dorë. Kërkon falje vazhdimisht për rregullin në shtëpi, paçka se mua më

### Pak patetike e justifikuar mërgimi

"Vërtet që jetoj ditën, por mikpritja mbetet e shenjtë", më thotë tek këmbëngul të më ofrojë drekën në një gjellore në qendër të Frozinones. Edhe aty na buzëqeshin të gjithë: "Mirëdita Profesor, profesor...".

Miqtë italianë e vlerësojnë aq shumë sa fotoreporteri Piero Pomponi po përgatit një "rrugëtim fotografik" në jetën e poetit. Derimë sot janë rreth dy mijë fotografi, që ndjekin jetën e Gëzimit nga fshati i lindjes e deri në Tanzani, ku duhet t'i kenë rrënjët të parë e familjes së tij... Një frozinonas, pasi ka përsëritur "Si je profesor?", ofrohet të na shoqërojë me makinë. Ndashemi sërish në stacionin e trenit, pasi kemi premtuar të takohemi si miq të vjetër në Romë, ku Gëzimi është i ftuar në Villa Borghese në 14 korrik për të lexuar disa nga poezitë e veta. Gjatë kthimit për në shtëpi më shoqëron e paturp një ndjesi dhembshurie patetike, që i ngjan pak solidaritetit mes bashkëvuajtësish në dhë të huaj. "Atdheu im është trupi im", më pat thënë Gëzimi, dhe tek është pasdite dhe dielli më perëndon diku pas kokës, shtrëngohem pas sediljes dhe kujtoj shtëpinë e fëmijërisë në Tiranë. Ah, po, vazhdoj të mendoj gjithësesi se të gjithë poetët njëjloj janë.

Ilirjana Stringa

Bota Shqiptare 88, korrik 2003



**Një shtëpi në Tiranë, kushton më pak se një garazh në Romë! Dhe vlera i rritet çdo ditë!**



*Planimetria e një apartamenti tip dhe lart pamje e simuluar e pallatit. Apartamentet në shitje janë në ndërtim e sipër.*

**Apartamente banimi në gjelbërimin e parkut të Liqenit, pranë kopshtit botanik të Tiranës.**

**Sipërfaqe të ndryshme  
Duke filluar nga 800 Euro m<sup>2</sup>**

**K & M Constructions**

Tiranë - 069-2080820

Romë - 334-2926786

nga Darling Ismail VLORA

**M**ë 28 qershor 1914, atentati i Sarajevos, ku mbeti i vrarë Arkiduka Franz Ferdinand i Austrisë (1863-1914), shërbeu si shkëndijë për shpërthimin e Luftës Irë Botërore. Shqipëria, ndodhur mes shteteve ballkanike, që gjithnjë kishin ëndërruar ta coptonin territorin e saj, si dhe pa mbrojtjen e dy Fuqive të Mëdha të asaj kohe, Austro-Hungarisë dhe Italisë, rivaliteti i të cilave kishte ndihmuar në krijimin e shtetit shqiptar, por që gjatë Luftës u rreshtuan në dy fronte armike, shumë shpejt do kthehej në një fushë-beteje midis forcave ndërluftuese.

Më 3 shtator 1914, pas gjashtë muaj "mbretërim", Princ Wied-i, shoqëruar nga anëtarët e Qeverisë së tij, u largua nga Shqipëria (duke i kaluar "përkohësisht" pushtetin KNKsë), veprim që e bënë edhe mjaft politikanë e patriotë shqiptarë, të cilët i kaluan vitet e vështira të Luftës në Europë. Edhe Ismail Qemali, bashkë me familjen, u largua nga Shqipëria dhe jetoi kryesisht në Itali, Austri, Francë e Spanjë. Gjatë kësaj periudhe, në të kundërt të shumë politikaneve të tjerë, Ismail Qemali nuk bashkëpunoi me asnjë nga qeveritë europiane, që kishin interesa të drejtpërdrejta apo indirekte ndaj Shqipërisë. Në shtator 1916, Qeveria franceze, nëpërmjet vetë Kryeministrit, Aristide Briand (1862-1932), kërkoi të gjente mbështetjen e Ismail Qemalit në politikën e saj ballkanike. Edhe pse në kushte të vështira ekonomike, Ismail Qemali e refuzoi "ofertën" franceze sepse e kishte të qartë që pas Francës fshihej Serbia. Shtetet europiane, në ato vite, kush më shumë e kush më pak, kishin interesat e tyre ndaj Ballkanit, prandaj vëmendja e Ismail Qemalit u përqëndrua në orientimin politik të presidentit amerikan Thomas Woodrow Wilson (1856-1924) dhe në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar ndaj çështjes shqiptare që, sigurisht, në përfundim të konfliktit, do rishikohej përsëri. Nga ana tjetër ishte në natyrën e Ismail Qemalit që, pasi të studionte mirë situatën politike ndërkombëtare, të gjente momentin e përshtatshëm për të vepruar, në dobi të vendit të tij. Ndërsa ndodhej në Paris, gjatë viteve 1915-18, në



Ismail Qemal Bej Vlora

Vlorë 24 janar 1844 - Perugia 24 janar 1919

## NË PËRVJETORIN E LINDJES DHE VDEKJES SË ISMAIL QEMALIT

# Shqipëria dhe Shqiptarët e Ismail Bej Vlorës

Një artikull i Ismail Qemalit botuar më 1917 në londinezin «Quarterly Review» është rimarrë e përpunuar nga stërnipi i tij Darling Vlora i cili, duke e mbushur me shënime, artikuj plotësues e ilustrime, ia ka zgjeruar tablonë historike duke e shndërruar në një libër të plotë dygjuhësh, dokument që më vete merr një rëndësi historike për të shfaqur edhe më në dritë ato çaste të tubullta historike para e pas shpalljes së pavarësisë që mbeten po aq të turbullta në trajtimet e historiografisë zyrtare shqiptare

bashkëpunim dy me gazetarë të njohur, amerikanin William Morton Fullerton dhe anglezin Sommerville Story, Ismail Qemali nisi të shkruaj "Kujtimet" e tij. Pikërisht në këtë periudhë ai i dërgoi revistës së njohur londineze "Quarterly Review", artikullin e gjatë "Shqipëria dhe shqiptarët", që u botua në kor-

rik 1917, Nr.452, f.140.

Themeluar më 1809, nga publicisti i njohur John Murray (1778-1843), "Quarterly Review" ishte një revistë prestigjioze, në faqet e së cilës kishin publikuar shkrimet e tyre dhe kishin bashkëpunuar personalitete të shquar të kohës si William Gifford, George Can-

ning, Robert Southey, John Lockhart, Lord Byron, Walter Scott, Robert Southey, Ugo Foscolo, Rowland Prothero, etj, etj.

"Shqipëria dhe shqiptarët", e "Shkëlqesisë së Tij Ismail Qemal Beut" (siç do shënonte editorit i revistës, në krye të artikullit), u paraqit krahas shkrimeve të Reginald Farrer, Alfred Frank



Darling Ismail Vlora, kurator i librit "Shqipëria dhe Shqiptarët" është stërnip i Ismail Qemalit dhe prej vitit 1998 jeton në Sirtori, në provincë të Leccos

## DARLING VLORA

# "Sa pak njihet historia e familjes Vlora"

**Darling, si zhvillohet trangu familjar i Vlorajve nga ku ke prejardhjen edhe ti?**

Unë kam lindur në Tiranë, më 1967, ku kam kaluar pjesën më të madhe të jetës sime. Jam martuar, më 1997, me Evis Golen, vajza e ish-Ambasadorit Astrit Golja, me të cilën kam një djalë, Ivin.

Linda në një familje «të varfër» edhe pse prindërit e mi vinin nga dy familje nga më të lashtat dhe më të pasurat shqiptare.

Im atë quhej Ismail Qemal Vlora. Ai kishte trashëguar emrin e gjyshit të tij, ngaqë ishte i pari djal që lindi në familje, pas vdekjes së Ismail Qemalit (Ismail Qemali vdiq më 24 janar 1919, im at lindi më 26 korrik 1920). Nëna



**Kopertina e librit dygjuhësh "Shqipëria dhe shqiptarët", përgatitur për botim, plotësuar me dokumente dhe e shënime historike nga Darling Ismail Vlora, konsultimet dhe përkthimet nga anglishtj Evis Golja. Libri ka 236 faqe dhe është i paisur me tregues të emrave. Në plotësimet historike, përveç shpjegimeve plotësuese, zëjnë një vend të veçantë:**

**-Ismail Qemal bej Vlora (dy fjalë për Heroin e Pavarësisë; Memorandumi i Gërçes;**

**-Drejt Pavarësisë;**

**-Kuvendi i Vlorës dhe Shpallja e Pavarësisë; Qeveria e Përkohshme e Vlorës**

**-Memorandumi i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Londër (janar 1913).**

Tredgold, Davison Charles, Walter F.Ford, André Lebon, Gerard Baldwin Brown, Antonio Fabra Ribas, Prof. Sir Paul Vinogradoff, Edmund Gosse, etj. Në artikullin e tij, pasi jep një panoramë të shkurtër të historisë së popullit shqiptar, të dokeve dhe zakoneve, të vendit ku ata jetonin, të sakrificave të tyre në mbrojtje të lirisë, të

luftës heroike nën udhëheqjen e Heroit Kombëtar Skënderbeu, Ismail Qemali përshkruan qartë periudhën e vështirë që kaloi Shqipëria gjatë viteve 1908-1914, dhe "i tërheq vërejtje" fuqive të Mëdha për qëndrimin e padrejtë që mbajtën ndaj popullit më të lashtë të Ballkanit, duke sakrificuar atë për të mbrojtur interesat e tyre.

Duke e ditur që përfundimi i Luftës do t'i ulte sërish në tryezë Fuqitë e Mëdha, Ismail Qemali e mbyll shkrimin e tij duke i bërë thirrje Europës për të korriguar këtë gabim: "...Rindërtimi i bllokut ballkanik dhe garancia e pavarësisë së tij, është një nga faktorët më efikas për paqen në Lindje e në botë. Kjo ndërtesë ballkanike

mund të konsolidohet vetëm me forcimin e Shqipërisë, e cila përbën njërin nga të katër kolonat që e mbajnë për të mos u rrëzuar...".

I zgjedhur nga shqiptarët e Amerikës me detyrë për të mbrojtur të drejtat e popullit shqiptar pranë Konferencës së Paqes, Ismail Qemali u largua nga Franca dhe u vendos në Spanjë, duke lënë të papërfunduar "Kujtimet" si dhe vazhdimësinë e këtij artikulli i cili, siç shkruan S.Story, "do pasohet me një ose dy të tjerë". Me dëshirën e madhe për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes në Paris, Ismail Qemali pranoi ftesën e Qeverisë italiane, për një bashkëpunim të mundshëm në interes të çështjes shqiptare, dhe u nis për Romë. Rrugës për në kryeqytetin italian "u urdhërua" të ndalonte në Peruxhia pasi "ata që e kishin ftuar nuk ndodheshin aty". Në këtë qytet, në rrethana akoma të errëta, burri i shtetit shqiptar mbylli sytë, më 24 janar 1919. Ëndrra e tij, që ta shikonte pa vdekur Shqipërinë me kufijtë etnike, mbeti e porealizuar. Megjithatë, më 17 nëntor 1918, pak para vdekjes, në një letër që u dërgonte shqiptarëve të Amerikës, u linte "testament" që "mos flinin dhe mos kursenin asgjë për shpëtimin e Shqipërisë... dhe me çdo frymë të fitonin Kosovën, Manastirin edhe Janinën, megjithë Çamërinë".

Në qershor 1920, një vit pas vdekjes së Ismail Qemalit, W.M.Fullerton dhe S.Story publikuan, në Londër dhe New York, "Kujtimet" e burrit të shtetit shqiptar. Duke qenë se këto "Kujtime" ndërpriteshin në vitin 1909, për të plotësuar vazhdimësinë e tyre, S.Story i bashkangjiti të plotë artikullin "Shqipëria dhe shqiptarët" i cili, edhe pse shkurtazi, jepte informacione mbi Shqipërinë, deri në largimin e Wied-it, më 1914.

Në përvjetorin e lindjes dhe vdekjes së Ismail Qemalit ribotojmë këtë shkrim duke shpresuar që të shërbejë, sado pak, për të plotësuar boshllëqet e mëdha dhe kontradiktat që ekzistojnë në evidentimin e saj, aq më tepër që, ky shkrim, mban firmën e vet protagonistit dhe farkëtuesit të Pavarësisë, duke na dhënë një tablo të qartë të përkushtimit të tij, për t'i dhënë Atdheut të drejtën që meritonte.

*Shkëputur nga parathënia e librit "Shqipëria dhe Shqiptarët" përgatitur dhe pajisur me shënime nga Darling Vlora*

## Pinjollit i një prej familjeve më të rëndësishme të historisë së Shqipërisë rrëfen trugun nga ku rrjedh dhe hijen e rëndë të Ismail Qemalit që errësoi thauja krejt pasardhësit e vet, në pjesën më të madhe të panjohur për publikum e gjerë.

ime, Esmë Hurshiti, ishte mbesë e patriotit dhe politikantit Javer bej Hurshiti, djali i adoptuar i Maliq Pasha Libohovës, nip i Ali Pashë Tepelenës. Prindërit e mi u martuan më 1945, pak pas «çlirimit», dhe rezultati i kësaj martesë ishte 5 fëmijë. Fëmija e parë, në kujtim të gjyshes (gruas së Ismail Qemalit) u quajt Kleoniqi (1959), më pas Ariana (1961); Qamil (1964); Elvinda (1965) dhe Darling (1967).

Gjyshi im, Qamil bej Vlora (babai i tim eti), ishte djali dhe fëmija i fundit i Ismail Qemalit. Ai kish lindur më 1895, në Stamboll, dhe u vendos përfundimisht në Shqipëri, pas vdekjes së të atit, më 1919. Po atë vit u martua

me Ylvie Dyrmishin, vajzë e patriotit Ahmet aga Dyrmishi, pjesëmarrës në Luftën e Vlorës dhe një nga trimat besnikë të Ismail Qemalit, me të cilën pati dy djem: Ismail Qemal (1920-90) dhe Xhevdet Sulejman (1922-93) [Martuar me Fatushë Kripa. Dy fëmijë: Ada (1965), Qemal (1966)].

Qamil Vlora ishte njeri me kulturë mjaft të gjerë dhe poliglot. Nermin Vlora, e cila e kishte njohur për një kohë mjaft të gjatë, e quante «enciklopedi e gjallë». Që i ri, u emërua Sekretar i Parë i Ministrisë së Jashtme. Më 1926, duke qenë në këtë detyrë, u nderua nga Presidenti i Republikës Franceze, Gaston Doumergue, me ur-

dhërin «Chavalier de la Légion d'Honneur» dhe, dy vjet më pas, më 1928, me propozim të Ministrisë së Jashtme, u dekorua nga Ahmet Zogu (në atë kohë President) «Kavalier i Urdhërit të Skënderbeut». Megjithatë, edhe pse nuk bëri pjesë asnjëherë në ndonjë parti politike, pikpamjet e tij, pas krijimit të Mbretërisë shqiptare, ishin të kundërta me ato të regjimit në fuqi dhe për këtë u akuzua të bënte pjesë në «Organizatën e fshehtë të Vlorës», një «komplot», që u zbulua në gusht 1932. Për t'i shpëtuar përdjekjes ai u detyrua të arratiset nga Shqipëria, së bashku me familjen. Nga ky vit, e deri më 1939, familja jetoi në

vijon nga faqja 21

Francë dhe Jugosllavi. Pas pushimit të vendit nga Italia, duke qenë se edhe akuza e tij si «komplotist» binte poshtë, pasi Ahmet Zogu ishte larguar nga vendi, gjyshi im, bashkë me familjen, pas 8 vjet emigrimi politik, u kthye në atdhe, duke punuar si këshilltar shteti, pa u përzier në asnjë parti politike të kohës. Në këtë detyrë qëndroi deri më 1944 kur vendi u çlirua nga pushtuesit gjerman për tu uzurpuar nga ai komunist.

Menjëherë pas «çlirimit» Qamil Vlorë, i vetmi nga djemtë e Ismail Qemalit që jetonte në Shqipëri, u thirr personalisht nga Mehmet Shehu «për të biseduar dhe shkëmbyer mendime lidhur me gjendjen e vendit». Im atë tregonte se Mehmeti e kishte pritur me shumë respekt dhe pasi kishin folur gjatë, duke shkëmbyer mendime mbi rrugëdaljet nga gjendja e vështirë e pasluftës, i kishte ofruar edhe poste të rëndësishme, deri përfaqësues të shtetit të ri në ndonjë nga vendet e Europës Lindore, por me disa «kushte». Një ndër to ishte prishja e fejesës së djalit të tij, Ismail, me vajzën e Mehmet Hurshitit dhe mbesë e Javer Hurshitit, babë e birë, në atë kohë, të arrestuar, nga ku i pari do dënohej me 15 vjet burg, që do i kalonte në famëkeqin e Burrelit, ndërsa i dyti do dënohej me pushkatim, në Gjyqin Special (prill 1945). «Qamili kishte refuzuar me finesë, -tregonte im atë, duke i kërkuar të mendohej, por ndërsa largohej e kishte «këshilluar» Kryeministrin e ardhshëm për të mos vazhduar më tej vëlla-vrasjen, pasi deri në atë kohë ishte ardhur shumë gjak shqiptari».

Sigurisht që ky takim «i dëshnuar» nuk do kalonte pa pasoja. Më 10 dhjetor 1946, Qamil Vlorë, arrestohet nën akuzën «armë mbajtje pa leje», pasi iu gjet një revolver, më shumë antik sesa funksional. Në burg u bë tuberkuloz dhe pas dy vjet mjekimi, në Senatoriumin e Tiranës, vdiq, më 15 dhjetor 1950, në moshën fare të re: 55-vjeçare. Familja e tij, gruaja dhe dy djemtë, përgjatë gjithë periudhës së egër komuniste u persekutuan. Më 1947, me vendim të «Komisionit të Kontrollit të rregjistruar», familjes sime iu ndryshua në mënyrë arbitrarë mbiemri nga «Vlorë» në «Ismaili», për të shkëputur lidhjen natyrore midis Ismail Qemal bej Vlorës dhe djemve e nipërve të tij. Megjithatë edhe pse «zyrtarisht» im atë figuronte me mbiemrin «Ismaili» ai vazhdoi të përdorë mbiemrin e tij të vërtetë në korrespondencat me kushërinjtë e tij jashtë Shqipërisë dhe kjo ishte një sfidë e hapur ndaj pushtetit, pasi dihet që siguri mi i atëhershëm kontrollonte gjithë korrespondencën me jashtë.

Im at, edhe pse kishte një kulturë të gjerë perëndimore dhe zotëronte mjaft mirë frengjishten, serbo-kroatishten dhe italishten, u luftua gjithë jetën, duke punuar nëpër punërat më të rën-



Darling Vlorë me bashkëshortin e tij, gazetaren Evis Golja

## “Sa pak njihet historia e familjes Vlorë”

da. Nënës sime nuk i pej punë. Ne, të pestë fëmijëve na u mbyllën dyert e shkollave. Ndoshta është e tepërt ta them por, edhe pse flitej e shkruhej për «Heroin e Popullit», që pas pesë shekujsh robërie Shpalli Pavarësinë, nipërit e tij (djemtë e djalit), nuk u thirrën asnjëherë që të përfaqësonin gjyshin e tyre, Heroin e Pavarësisë, të paktën në ceremonitë e 28 nëntorit, në Vlorë!!! Megjithatë im atë, privatisht, shkante gjithmonë tek varri i tij dhe vinte një kurorë duke shënuar emrat e të gjithë nipërve e mbesave që jetonin jashtë Shqipërisë dhe që, për një arsye apo tjetër, nuk mund të vinin në Shqipëri.

**A mund të më tregosh ndonjë histori të njohur pak nga Familja juaj, që ka lidhje me Ismail Qemalin apo me djemtë e tij?**

E gjithë historia e familjes së Ismail Qemalit njihet pak. Rrallë ndonjëherë, kur flitet për një personalitet të madh historik, familja e tij, paraardhësit dhe pasardhësit, lihen në harresë. Kjo ndodhi me Ismail Qemalin. Si figurë madhore dhe me një popullaritet të madh, diktatura komuniste e kishte vështirë ta injoronte, por nga ana tjetër ai u paraqiti i veçantë, thujse njeri pa njeri. Akoma edhe sot, në punimet kushtuar Ismail Qemalit flitet fare pak për familjen e tij, për rolin

drejtues që të parët e tij kishin pasur për shekuj me radhë, për kontributin e madhe të gjyshit dhe babait të tij në kryengritjet e gjysmës së parë të shek.XVIII. Kontributi i Ismail Qemalit pak as shumë dihet por, një vend të veçantë në këtë kontribut zëjnë edhe djemtë e tij, veçanërisht Et'hem bej Vlorë dhe Qazim bej Vlorë të cilët, gjatë periudhës më të rëndësishme të veprimtarisë së Ismail Qemalit e deri ditën kur vdiq, më 24 janar 1919, i ndejtën gjithmonë pranë, duke e shoqëruar kudo, në çdo aktivitet, takim, udhëtim, etj. Historia jonë, jo vetëm që nuk u ka dhënë akoma vendin e merituar, por e ka lënë krejtësisht në harresë veprimtarinë e madhe të tyre.

**Ku ke jetuar në Shqipëri?**

Darling Vlorë: Më 1944 familja ime jetonte në një apartament të madh, në lagjen Tirana e Re. Pas «çlirimit», duke qenë se ky apartament konsiderohej «i madh» për familjen time, pushtetarët i morën disa dhoma dhe ua dhanë «oficerëve» partizanë e, më pas, i nxorrën fare nga shtëpia. Më 1964 prindërit e mi, në atë kohë me dy fëmijë, ishin pa shtëpi dhe jetonin nëpër kushërinj. Ndërsa nëna priste fëmijën e tretë, babai im shkoi në Komitetin Ekzekutiv të Tiranës dhe mori takim me një nga drejtuesit e atij Komitetit. «Nëse ju nuk do më jepni shtëpi, i kish deklaruar im atë, unë do marr gruan dhe fëmijët dhe do flej përpara Komitetit që ta shikojnë të gjithë sesi vuan familja e Ismail Qemalit dhe jam i bindur se, me këtë sjellje që ju po bëni tregoni që, po të ishte gjallë gjyshi im, do ta kishit futur në burg». Unë nuk e di se ç'e shty atë drejtues të Komitetit por di që nga ajo zyrë im atë doli me autorizimin e një apartamenti të vogël, ku sot vazhdon të banoj nëna ime. Familja ime ka jetuar në kushte shumë të vështira ekonomike. Në familjen tonë, prej shtatë vetash, vetëm im atë punonte dhe rroga e vogël e tij nuk dilte për të përballuar kërkesat e familjes. Gjatë kësaj periudhe të vështirë na kanë ardhur në ndihmë kushërinjtë e tim eti që jetonin jashtë

Shqipërie, veçanërisht Nermin Vlorë dhe Aleksandër Vlorë.

**Kush kanë qenë pasardhësit e tjerë të Ismail Qemalit që kanë jetuar jashtë Shqipërisë dhe çfarë lidhesh ke pasur me ta?**

Darling Vlorë: Ismail Qemali u martua më 1867. Gruaja e tij, Kleoniqi Surmeli, ishte me origjinë greke. Nga kjo martesë lindën nëntë fëmijë: gjashtë djem: Mahmud bej, Tahir bej, Et'hem bej, Xhevdet bej, Qazim bej, Qamil bej dhe tre vajza: Myvedet, Alije, Ylvia. Nga djemtë e tij vetëm dy lanë trashëgimtar: Mahmud beu (djali i madh) dhe Qamil beu (djali dhe fëmija më i vogël). Pas vdekjes së Mahmud beut, më 1921, familja e tij (gruaja, Alice, dhe tre fëmijë: Aleksandër, Suzana, Blanche) u vendos në Itali. Përveç tyre u larguan nga Shqipëria dhe tre mbesa të Ismail Qemalit (vajza të vajzave): Belkiz Vlorë (nëna e Nerminit), Samie Mirdash (gruaja e gjeneral Mirdashit, pushkatuar më 1945) dhe Sara Blloshmi (nëna e piktores Vera Blloshmi). Im atë kishte një korrespondencë të rregullt me të gjithë kushërinjtë e tij, nipër e mbesa të Ismail Qemalit, që jetonin jashtë Shqipërisë, veçanërisht me Aleksandër Vlorën (djali i Mahmud beut) dhe Nermin Vlorën (mbesë e Myvedetit). Edhe pas vdekjes së babait tim ne vazhduam t'i mbajmë lidhjet me kushërinjtë tanë. Unë kam patur rastin t'i njoh nga afër disa prej tyre. Më 1990 kam qëndruar rreth dy muaj në shtëpinë e Aleksandër Vlorës (babai i prof.Nedim Vlorës), në Bari. Më pas kam qëndruar rreth një vit në Romë ku, me ndihmën e Nermin Vlorës, kreu një kurs për kompiuter.

**Pse u largove nga Shqipëria?**

Darling Vlorë: Herën e parë u largova nga Shqipëria më 1991 dhe, siç thashë, jetova një vit në Romë. U ktheva në Shqipëri në fund të vitit 1992, me dëshirën që të punoja në vendin tim. Deri në vitin 1998 punova pranë Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë. Në këtë vit, pas ndryshimeve politike sidhe për shkak të situatës së rëndë të krijuar gjatë vitit 1997, u largova nga Shqipëria, së bashku me gruan dhe djalin e sapolindur.

**A do të ktheheshe në Shqipëri?**

Darling Vlorë: Nuk besoj që të ketë emigrant shqiptar që mos mendojë të kthehet një ditë në vendin e tij. Prej gati 10 vjetësh jetoj dhe punoj në Itali dhe çdo vit i kaloj pushimet në vendin tim. Kur jam në Shqipëri gjithmonë gjej rastin dhe vizitoj Vlorën, qytetin e të parëve të mi, që, fatkeqësisht, sa vjen e bëhet më i huaj për mua, dhe ndaloj një çast përpara varrit të Ismail Qemalit, duke kujtuar të gjithë të afërmit e mi, ata që janë larg dhe ata që s'jetojnë më.

Bisedoi Dorian Metollari, Hermes News. Courtesy of Hermes News.



**WESTERN  
UNION** | |<sup>®</sup>

**RISIA**

**Shërbimi Western Union  
është i pranishëm edhe  
në pikat SISAL të autorizuara  
ku është e pranishme marka **

Për informacione të mëtejshme telefono në numrin e gjelbër 800 220055



*Il tuo Centro Servizi*

**M** 16 Dhjetor 2008 u zhvillua ne Torino koncerti "Tingujt e Krishtlindjeve" i Korit Polifonik "Prenke Jakova" te qytetit te Shkodres. Per rreth nje ore e gjysme, disa qindra artdashes torineze, Italjane dhe Shqiptare ndoqen me kenaqesi e interes performancen e artisteve Shkodrane. Maestro Gjon Shllaku, artistet Rozela Gjylbegu, Aleksander Tuka, Enrik Cela, Ylber Tahiri, Elnaida Dani dhe i gjithë kori "Prenke Jakova" sollen ne skene pjeset me te mira te muzikes polifonike perendimore dedikuar temes se Krishtlindjeve si edhe nje repertor te pasur me kenge te tradites popullore Shqiptare e ballkanike.

"Ky koncert ishte per mua nje kenaqesi dhe nje emocion i vecante" u shpreh drejtuesi i korit, maestro Gjon Shllaku. "Performancat e suksesshme perballe publikut perendimor tregojne se Shqiperia dhe artistet e saj kane se cfare vlerash te eksportojne jashte kufijve te vendit. Falenderoj organizatoret e kesaj veprimtaria e ne vecanti Shoqaten Vatra per mundesine qe na dha te performonim perballe publikut Torinez."

Koncerti "Tingujt e Krishtlindjeve" u mbeshtet zyrtarisht edhe nga Bashkia e Qytetit te Torinos. Per Anna Ferrero-n, drejtueshe e departamentit te kultures prane ketij institucioni "shfaqja e kesaj mbremjeje ishte nje dhurate e bukur qe bashkesia Shqiptare i beri qytetareve te Torinos." "Vendi juaj ka vlera te mrekullueshme kulturore e artistike dhe ne jemi me fat qe kemi mundesine te njihemi e ti shijojme ato. Keto veprimtari deshmojne gjithashtu se Shqiptaret ne Torino jane tashme te integruar mjaft mire dhe kane nisur te kontribuojne seriozisht edhe ne pasurimin e jetes kulturore te qytetit tone." vijoi ajo.

Mbremja galà u organizua nga Shoqata Kulturore Italo-Shqiptare "Vatra" e Torinos, nje prej organizatave me aktive Shqiptaro-Italjane te Italisë se Veriut, ne bashkepunim me Konsullaten e Pergjithshme te Shqiperise ne Milano, Zyren e Perfaqesimit te Dhomes se Tregtise se Tiranës ne Torino dhe me



Shoqata Vatra vazhdon të mbajë ndezur në kryeqendrën piemonteze traditën e veprimtarive dinjitoze

## Tingujt e Krishtlindjeve vijne në Torino me Korin Polifonik Prenkë Jakova



organizaten ACLI te rajonit te Lombardise. Ajo kishte per qelim edhe sensibilizimin e opinionit dhe mbledhjen e fondeve ne mbeshtetje te projektit "Albania" te organizates humanitare ACLI qe vepron tashme prej disa vitesh ne qarkun e Shkodres.

Sipas Vasenka Rangut, perfaqesueses se kesaj organizate per rajonin e Lodit, ne Lombardi "mbremja ishte nje event i suksesshem ku kenaqesia e dhuruar nga performanca live e artisteve te talentuar te korit "Prenke Jakova" gershetohet

mjaft mire me ate te mbeshtetes se nje projekti te rendesishem humanitar qe prek jeten e shume te rinjeve e te rejave ne rajonin e Shkodres."

Mbremja galà shoqeroheje edhe nga ekspozita fotografike "Shqiperia Turistike 2008" e realizuar nga te rinjte e Shoqates Vatra ne kuader te projektit "Te rinjte e rruges Egnatia" qe synon promovimin e Shqiperise si destinacion turistik.

Benko Gjata

## Shoqata e studentëve të Bolonjës në një mbremje poetike të letrave shqiptare

Vetëm disa metra larg kullës Asinelli e Garisenda, simbole të qytetit te Bolonjës, te "Arteria" ne Vicolo Broglio, me 12 dhjetor 2008 u zhvillua mbremja letrare dedikuar poezisë shqipe. Nuk eshte hera e parë që studentët e USAB impenjohen në aktivitete të tilla e kjo mbremje i shtohet përpjekjeve të tyre për të afirmuar kulturën e vendlindjes e njëkohësisht promovimin e saj.

Aktiviteti edhe për orën në te cilen zhvillohej (9 e mbremjes) kishte mundësiuar pjesmarrjen e shumë studentëve, por edhe të miqve të Shqipërisë e kulturës shqiptare.

Materiali poetik ishte i përzgjedhur dhe përkthimet ishin realizuar pothuaj të gjitha nga studenti Visar Sylaj (Fakulteti i gjuheve te huaja), i cili edhe bente pjesë te grupi i interpretuesve.

Prezantimi i cdo krijimi poetik paraprihej nga një njohje e shkurtër biografike e autorit.

Tre studente shqiptare Gerta Gega, Genta Cela e Visar Sylaj si dhe studentja italiane Valeria Zannerio interpretuan në alternime poezitë në shqip e në italisht. Keshtu me radhe u prezantuan poezi nga Ali Prodrimja, Dritero Agolli, Fatos Harapi, Ismail Kadare, Kasem Trebeshina, Martin Camaj, Mimoza Ahmeti, Visar Zhiti si dhe poezi e krijime te vetë studenteve.

Atmosferen e ngrohu me tinguj violincelisti kroat Pere Jovanov që bashkë me recituesit mori duartrokkitjet e të pranishëmve.

USAB - kjo shoqatë studentore që mbledh djem e vajza shqiptare, të cilët studiojnë





në Universitetin e Bolonjës me aktivitetet e saj të kulturës ekspozita fotografike, mbrëmje letrare-poetike, projekte filmash shqiptarë e festime përvjetoresh po forcon fizionominë e saj e meriton vemëndjen e mbështetjen për këto aktivitete të Universitetit si dhe bashkëpunimin më shoqata të tjera

**Albana Temali**



**ALESSANDRIA**  
**"One" ekspozitë kolektive.**  
**Me pjesëmarrjen e artistëve shqiptarë Alfred Mirashi Milot, Artan Shabani.**

**inauguruar më 8 dhjetor 2008 hapur deri më 31 janar 2009**

**Palazzo Melchionni, Via Migliara, 17, Alessandria**



**MILANO**  
**"TU vuoi essere attore o comparsa?"**

**Ekspozitë e Helidon Xhixhës inauguruar më 10 dhjetor 2008 hapur deri më 20 janar 2009**  
**Barclay's Premier via dei Mercanti, 10 20121 Milano**



Sapore di casa

# Në një dado-supe të vogël, një kuzhinë e madhe.

*Me Maggi® mund të fitosh një Kuzhinë*

Jepi shije specialiteteve tuaja me një dado-supe (ekstrakt) të thjeshtë dhe mund të fitosh një kuzhinë të mrekullueshme.

Blej një konfeksion me dado-kuzhine **Maggi**, plotësoje kuponin me të dhënat tuaja dhe dërgoje së bashku me kodin me viza të artikullit dhe fletëpagesën (scontrino) në adresën e dhënë: të gjithë kuponët që mblidhen brenda datës 09-04-15 do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për një kuzhinë të mrekullueshme.

Konsulto rregulloren në seksionin e caktuar për kuzhinën etnike në internet [www.stranieriinitalia.it](http://www.stranieriinitalia.it) dhe zbulo librin e recetave të kuzhinës ndërkombëtare që ofrohet nga Maggi® edhe ti mund të dërgosh recetën tënde!

Nome \_\_\_\_\_ Cognome \_\_\_\_\_

Sesso\*  F  M Residente a: Città \_\_\_\_\_ Prov \_\_\_\_\_

Via \_\_\_\_\_ n° \_\_\_\_\_ Cap

Tel \_\_\_\_\_ email\* \_\_\_\_\_

**Buono Sconto**

482050085

**0,30€**

**Maggi**

Valido per l'acquisto di una confezione a scelta tra Dado Ricetta Mediterranea e Dado Ricetta Originale

AVVERTENZE AL CONSUMATORE - Per ottenere lo sconto il buono deve essere presentato al negoziante entro il 01/06/2009. AVVERTENZE AL RIVENDITORE - Per ottenere il rimborso di questo buono sconto, si prega di inviare il medesimo alla Nestlé Italiana S.p.A. presso VALASSIS S.r.l. - Casella Postale 14250 - Via Grosio 10/8 - 20151 Milano. La Società rimborserà questo buono sconto solo se utilizzato dal consumatore per l'acquisto del prodotto. Ogni altro uso verrà perseguito nei termini di legge. Non saranno rimborsati buoni non integri in ogni loro parte o che comunque presentino segni di manomissione o alterazioni. Il rimborso dei buoni potrà essere sospeso qualora venisse rilevata la non corrispondenza tra il numero dei buoni presentati e la quantità di prodotto acquistato.

KONKURSI SHIFTEI NË LESHËNËNG, DATA 08-11-01 FEBRILË ME 09-03-31. SHORTI PËR NUMËR TËRHIQHJET BREZIDA, DATËS 09-04-30. VLERË E PËRQITËSHMË E COMEVE SHIFTEBENËS, 02.22€ (PËR SHIFRË TË SHIFRË), RREGULLOAR E FOTOGRAFUE NË INTERNET: [www.stranieriinitalia.it](http://www.stranieriinitalia.it). LORE: REFERONET NUMËRIT 73817804545454.

**Teksti unik për imigracionin u njeh të huajve, që përm-bushin disa kushte, mundësinë e konvertimit të lejes së qëndrimit në një tjetër për punë. Ja si veprohet në raste të ndryshme:**

**Konvertimi nga leje për studime në leje për punë (për studentë të përdiplomuar në Itali)**

Të huajt që kanë leje qëndrimi për studime apo për formim profesional të paskaduar, mund të kërkojnë konvertimin e dokumentit të qëndrimit në një leje për motive pune të varur apo të pavarur, por vetëm në kuadrin e kuotave vjetore të përcaktuara me dekretet e flukseve.

Kështu, për të paraqitur kërkesë për konvertim është e domosdoshme që të ketë një dekret fluksesh që të parashikojë një gjë të tillë. Në dekretin zakonisht përcaktohet numri i kuotave të rezervuara për konvertimin e lejeve të qëndrimit nga studime në punë të varur apo të pavarur si dhe dita nga kur mund të fillojë paraqitja e kërkesave të tilla.

Kërkesa për konvertim paraqitet përmes procedurës telematike të ministrisë së Brendshme ([www.interno.it](http://www.interno.it)). Formularët që duhen plotësuar janë:

- V: konvertim nga studime në punë të varur;

- Z: konvertim nga studime në punë të pavarur.

Sporteli Unik me të marrë kërkesën ia përcjell atë Drejtorisë provinciale të punës, e cila verifikon nëse ka ende kuota në dispozicion dhe ia komunikon këtë fakt sportelit. Nëse nuk ka kuota të lira Sporteli Unik ia komunikon këtë të interesuarit.

Në rast se ai e përfiton një kuotë, i huaji do të thirret pranë Sportelit Unik për të çuar kontratën e qëndrimit (formulari Q) të përpiluar në të gjitha fushat dhe të nënshkruar nga punëdhënësi (në rastin e konvertimit

# KONVERTIMI i lejeve të qëndrimit



për punë të varur). Orari i punës i shkruar në kontratë duhet të jetë mbi 20 orë në javë.

**Konvertimi nga leja për studime në punë (për studentë të diplomuar në Itali)**

Studentët e huaj që kanë marrë në Itali diplomën e shkollës së lartë apo të shkollës së specializuar mund të kërkojnë konvertimin e dokumentit të qëndrimit në leje për punë të varur apo të pavarur pavarësisht nga ekzistenca e një dekreti fluksesh, pra në çdo çast të vitit.

Kërkesa për konvertimin mund të bëhet përmes procedurës telematike të ministrisë së Brendshme duke përpiluar këta formularë:

- V2: konvertim nga studime në punë të varur;

- Z2: konvertim nga studime në punë të pavarur.

Kujdes: nëse i huaji ka ndjekur një kurs studimi njëvjeçar - për shembull kurs i gjuhës italiane, edhe pse pranë një universiteti - ai nuk mund të kërkojë konvertimin e lejes për studime në leje

për punë jashtë kuotave të flukseve.

**Leje qëndrimi për motive familjare: konvertimi me mbushjen e moshës 18-vjeçare**

Neni 31 i tekstit unik për imigracionin parashikon që të miturit të huaj mbi 14 vjeç, i regjistruar në lejen apo kartën e qëndrimit të prindit, t'i lëshohet një leje për motive familjare deri në mbushjen e 18 vjeçeve. Në çastin kur i mituri mbush moshën madhore mund të kërkojë konvertimin e kësaj lejeje në një tjetër për motive studimesh, futjeje në tregun e punës, për punë të varur apo të pavarur apo për kura mjekësore, jashtë kuotave të dekretëve të flukseve. Kërkesa duhet të paraqitet duke përpiluar këta formularë:

- V2: konvertim nga studime në punë të varur;

- Z2: konvertim nga studime në punë të pavarur.

Megjithatë, mund të ndodhë që 18-vjeçari i huaj, me

Neni 31 i tekstit unik për imigracionin parashikon që të miturit të huaj mbi 14 vjeç, i regjistruar në lejen apo kartën e qëndrimit të prindit, t'i lëshohet një leje për motive familjare deri në mbushjen e 18 vjeçeve. Në çastin kur i mituri mbush moshën madhore mund të kërkojë konvertimin e kësaj lejeje në një tjetër për motive studimesh, futjeje në tregun e punës, për punë të varur apo të pavarur apo për kura mjekësore, jashtë kuotave të dekretëve të flukseve

qëndrim të rregullt në Itali (titullar i një lejeqëndrimi për motive familjare), të mos ketë vendosur ende se ç' do të bëjë, studime apo punë, ose të mos jetë në gjendje të përmbushë kushtet e kërkuara për lëshimin e një prej lejeve të sipërpërmendura. Pikërisht për këtë arsye, ministria e Brendshme me një qarkore të 28 marsit 2008 ka parashikuar që në të tilla raste i huaji 18-vjeçar mund të kërkojë përtëritjen e lejes së qëndrimit për motive familjare përmes kompletit postar të formularëve, dhe jo konvertimin. Në qarkore parashikohet që "në çastin e mbushjes së 18 vjeçeve, titullarit të lejes së qëndrimit për motive familjare, mund t'i përtërihet leja e qëndrimit për të njëjtën kohëzgjatje me atë të prindit, me kusht që ky i fundit të përmbushë kushtet e të ardhurave dhe të strehimit që kërkohen për bashkimin familjar".

Teresa Olivadese  
[www.stranieriinitalia.it](http://www.stranieriinitalia.it)

Më 15 dhjetor 2008 hyri në fuqi dekreti i ri i flukseve. Me përfundim të numrit të kuotave, që është ulur nga 170 në 150 mijë, gjithë risitë e tjera të këtij fluksi ishin bërë të njohura në rrugë jo zyrtare.

Në radhë të parë duhet thënë që për këtë dekret fluksesh nuk paraqiten kërkesa të reja por do të merren parasysh ato të paraqitura deri më 31 maj 2008, në kuadrin e flukseve 2007. Por nga kuotat e këtij fluksi do të përfitojnë bashkëpunëtorët familjarë, për të cilët janë vënë në dispozicion 105.400 vende, dhe shtetasit e 14 vendeve me të cilat Italia ka lidhur marrëdhënie dypalëshe (kuotat në favor të këtyre shtetasve janë po ato të vitit të shkuar, gjithsej 44.600). Vetëm për shtetasit e këtyre 14 vendeve do të merren parasysh edhe kërkesa që nuk janë për bashkëpunëtorë familjarë. Ashtu si edhe vitin e shkuar, për shqiptarët janë vënë në dispozicion vetëm 4.500. Shumë pak, po të mbahet parasysh që për ta janë paraqitur rreth 36 mijë kërkesa. Madje mund të thuhet që këto kuotat e rezervuara duken më tepër si penalizuese se sa në favor të shtetasve të këtyre vendeve. Për të dhënë një shembull: shqiptarja e thirrur për të mbajtur një të moshuar që do të renditet në vend të 4501-të në listën e shqiptarëve, por që është ndër 105 mijë të parët e të thirrurve si bashkëpunëtorë shtëpiakë, nuk do të përfitojë një kuotë. Po të mos ishte në listën e "vendeve me kuota të rezervuara" do të kishte më shumë shanse. Këtë herë, e vetmja gjë pozitive është që shqiptarët do të mund të vijnë në Itali edhe nëse nuk thirren për të punuar pranë familjeve.

Edhe pse nuk do të paraqiten kërkesa të reja, punëdhënësve të huaj iu nevojit të lidheshin sërish me ëeb-site-in e ministrisë së brendshme. Iu kërkua të deklaronin se janë titullarë të kartës së qëndrimit (apo titullarë të lejeqendrimit CE për qëndruesit afatgjatë ose e kanë kërkuar këtë dokument para datës 10 dhjetor 2008, datë e shpalljes së dekreti në Gazetën Zyrtare) dhe të konfirmonin kërkesën e tyre të paraqitur muaj më parë në kuadrin e flukseve 2007. Këtë detyrim nuk duhet ta përmbushnin ata që janë përfaqësues ligjorë të 'personave juridike' me seli në Itali, por të gjithë të huajt që kishin kërkuar një bashkëpunëtorë familjarë si dhe ata që kanë një ndërmarrje individuale (p.sh.

# FLUKSET 2008



Për këtë dekret fluksesh nuk paraqiten kërkesa të reja por do të merren parasysh ato të paraqitura deri më 31 maj 2008, në kuadrin e flukseve 2007. Por nga kuotat e këtij fluksi do të përfitojnë bashkëpunëtorët familjarë, për të cilët janë vënë në dispozicion 105.400 vende, dhe shtetasit e 14 vendeve me të cilat Italia ka lidhur marrëdhënie dypalëshe. 4500 vende për shqiptarët.

dikush që ka një 'partita iva' personale e ka kërkuar të punësojë një ndihmës). Për këtë veprim ata kishin në dispozicion 20 ditë, nga 15 dhjetori 2008 deri në orën 24 të 3 janarit 2009. Nuk janë shumë po të mbahet parasysh që ishte periudha e vitit me më shumë ditë

festive dhe shumëkush mund të ishin kthyer në atdhe për festa. E megjithatë u paraqitën mëse 120 mijë konfirmime: 21 mijë vetëm më datë 15 dhjetor, mbi 70 mijë deri më 22 dhjetor, mbi 104 mijë deri më 31 dhjetor e 116 mijë deri në mëngjesin e 2 janarit.

Flukset 2008 në gjykatë  
Për sindikatat s'htimi  
i kushtit të kartës  
së qëndrimit  
është i paligjshëm

Sindikata Cgil dhe patronati Inca kanë depozituar tashmë një ankesë në Gjykatën administrative të Lazio-s kundër dekretit të flukseve që u ka hapur dyert 150 mijë të huajve. Sipas sindikatës dhe patronatit, t'u kërkosh punëdhënësve të huaj kartën e qëndrimit (pra të shtosh një kërkesë me shumë vetëm për të huajt) shkel qoftë ligjin kundër imigracionit, qoftë

disa parime kushtetuese.

Qeveria italiane ka futur këtë kufizim për të situar edhe më tej kërkesat e punësimit, për të shmangur sa më shumë ato që mund të fshehin përpjekje për të mundësuar nxjerrjen nga klandestiniteti të miqve apo për bashkime familjare. Por kjo gjetje e re e qeverisë krijon në këtë mënyrë një diskriminim të punëdhënësve të huaj.



**Specialisti për fluturime charter, low cost, fluturime linje dhe tragete**

• Tiranë

• Durrës

• Vlorë

**Kërkojmë agjentë shqiptarë dhe call center për shitje biletash avioni dhe treni.**

Prenotime Fluturim, Hotel, Makina me qira, Tragete dhe Trena në Shqipëri edhe me telefon, me çmime konkurruese.

**TURISADRIA VIAGGI**

**VIA MAZZINI 119/C 47042 CESENATICO (FC)**

**Tel. 0547.82492 – 0547.674221 - 340.7089484**

**www.volialbania.it**

# Ende asnjë udhëzim mbi njohjen e patentave shqiptare në territorin italian

Dy muaj pas firmosjes së marrëveshjes, shumë shtetas shqiptarë që u drejtohen Zyrave të Motorizimit Civil për konvertimin e

## PATENTAT SHQIPTARE

patentës, marrin ende si përgjigje se normativa e re nuk ka hyrë ende në fuqi.

Në kuadrin e bashkëpunimit në sektorin e transporteve të nisur nga qeveritë e të dy vendeve, ministri i jashtëm Italian Franco Frattini, më 27 tetorin e kaluar në Tiranë, firmosi marrëveshjen për njohjen reciproke dhe konvertimin e patentave për dhënien e makinës, në prani të kryeministrit shqiptar Sali Berisha, dhe ministrit të jashtëm Lulzim Basha. Por deri më sot, për emigrantët shqiptarë në Itali nuk ka ndryshuar asgjë. Sepse që kartat e firmosura në Tiranë nga ministri i Jashtëm Frattini, të kenë vërtet vlerë, të aplikohen, duhet që ministria italiane e transportit të nxjerrë një qarkore, dekret apo urdhëresë ministrare apostafat për këtë çështje, gjë që ende nuk është bërë. Por sidoqoftë, tashmë dita e konvertimit të patentave shqiptare duket se është shumë më e afërt se deri një muaj më parë.

Pas nxjerrjes së dekretit nga ministria italiane e Transportit, për shtetasit shqiptarë rezidentë në Itali konvertimi i patentës shqiptare do të bëhet në mënyrë automatike, pa pasur nevojë për të kaluar provime të tjera teorike apo praktike. Ata që kalojnë apo banojnë në Itali për një periudhë më të shkurtër se një vit, nuk do të kenë më nevojë të marrin patentë ndërkombëtare, por mund të lëvizin normalisht me patentën e tyre shqiptare, duke kursyer kështu kohë e para. Për ata që jetojnë në Itali më gjatë se një vit, kodi rrugor italian parashikon ose konvertimin e patentës shqiptare ose duke vazhduar me mënyrën e vjetër, marrjen e patentës italiane. Dhe shqiptarët, që deri më sot kanë dhënë provimin për marrjen e patentës italiane, i njohin mirë

vështirësitë me të cilat duhet të përballen gjatë provimit teorik të patentës (veçanërisht pyetjeve kurth) në një gjuhë të cilën jo gjithmonë e njohin në mënyrë të përkryer.

Deri në 2004, patentat kombëtare shqiptare cilësohej pa elemente sigurie të parashikuara nga marrëveshja e Gjenevës, gjë që nuk linte asnjë mundësi për konvertimin e saj. Me ardhjen në fuqi të kodit të ri rrugor shqiptar (që mes të tjerash, vështirëson marrjen e patentës) dhe

luftën kundër falsifikimeve të dokumenteve, konvertimi reciprok i patentave, shumë shpesh i përmendur nga qeveria e Tiranës, dukej vetëm një formalitet. Por në të vërtetë u deshën plot katër vjet për të parë të shkruar të zezë mbi të bardhë një marrëveshje (që në të vërtetë ende nuk është e aplikueshme) që shënon një hap të vogël por thelbësor në procesin e afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Katër vjet duke pritur të ashtuquajturat kushte të

reciprocitetit të cilat mbërrijnë vetëm tani në momentin kur Italia është duke u përpjekur të përforcojë rolin e saj si partner kryesor tregtar e politik, si edhe në momentin e hyrjes së Shqipërisë në Nato pas rreth një viti. E megjithatë dy muaj pas firmosjes së marrëveshjes, shumë shtetas shqiptarë që u drejtohen Zyrave të Motorizimit Civil për konvertimin e patentës, marrin ende si përgjigje se normativa e re nuk ka hyrë ende në fuqi.

## BONUS

## FAMIGLIA

### Nga 200 deri në 1.000 euro për familjet me të ardhura të ulëta

Bonusi për familjet i parashikuar nga paketa anti-krizë e qeverisë, këtë herë u takon edhe emigrantëve, njësoj si italianëve.

**N**eni i parë i dekretligjit 185/2008 shpjegon që bonusi u takon "subjekteve rezidente" pjesëtarë të familjeve me të ardhura të ulëta. Rezidentë, pra të regjistruar në zyrat e Gjendjes Civile, siç janë zakonisht të gjithë ata që kanë një dokument qëndrimi në Itali.

Bonusi mund të kërkohet nga punonjës dhe pensionistë (janë të përjashtuar punonjësit e pavarur, sipërmarrësit e vegjël, kush ka 'partita iva') dhe është një shumë që ndryshon në varësi të të ardhurave. Shkon nga 200 euro që do t'u takojë pensionistëve me të ardhura deri në 15 mijë euro, deri në 1.000 që do t'u jepen familjeve me mbi pesë vetë me të ardhura deri në 22 mijë euro në vit.

Për të ardhurat vjetore merret parasysh shuma e të ardhurave të të gjithë përbërësve të familjes. Bonusi kërkohet një herë dhe vetëm nga një pjesëtar i familjes, por kadenca për paraqitjen e

kërkesës është e ndryshme në varësi të vitit sipas të cilit do të konsiderohen të ardhurat. Nëse zgjidhet që të merren parasysh të ardhurat e vitit 2007, kërkesa për bonusin duhet paraqitur brenda 31 janarit 2009, kush zgjedh që t'i merren parasysh të ardhurat e vitit 2008 ka kohë të paraqesë kërkesën deri më 31 mars 2009.

Punonjësit e varur duhet t'i paraqesin kërkesën e bonusit punëdhënës të tyre, bashkëpunëtorët shtëpiakë pranë sporteve të Agjencisë së të Ardhurave, pensionistët dhe të papunët duhet t'i drejtohen INPS-it. Paratë e bonusit do të mbërrijnë pas një muaji drejtpërdrejt në rrogë (punëdhënës do të rimbursohen nga shteti) ose në pension.

Formularët dhe udhëzuesi për kërkesën mund të shkarkohen nga web-site [www.agenziaentrate.it](http://www.agenziaentrate.it), por kush dëshiron mund të kërkojë informacione dhe ndihmë falas pranë patronateve.



Identiteti dhe kulturat e një kryeqyteti multi etnik

# Tregoni historinë tuaj



Dërgo fotografi, video dhe mesazhe zanore tek

# [www.migrart.it](http://www.migrart.it)



Comune di Milano



contrasto



1	2	3		4	5	6				
7			8		9					10
11			12		13		14	15	16	17
			18		19					
20		21								
22	23								24	
25								26		
27				28				29		
		30	31					32		
33	34					35	36			37
38			39			40			41	42
43					44					

**HORIZONTALISHT**

1. Brokoviç me Julia Roberts. 4. Jodie, aktore. 7. Njësi monetare e Shqipërisë. 9. Zbehu pa teke. 11. Smith, këngëtare e famshme amerikane. 14. Caçe kohore që duhen respektuar. 18. Lëndë plasëse si dinamiti. 21. Një fjalë njëqind vjeçare. 22. Aspak tërheqës. 24. Flori. 25. Bernardo, bomber i Parmës. 26. Spikat tek egoisti. 27. Italia në tabelat elektronike. 28. Pak municione. 29. Këndohet në opera. 30. Bima nga e cila nxirret edhe vaji. 32. Rruga e italianëve. 33. Vampiri i Klaus Kinskit. 38. Përpara Greco-s piktor. 39. Përemër i gjuhës angleze. 40. Maria, soprano e madhe. 43. Errësirë. 44. I ëndrrave i Kadarese

**VERTIKALISHT**

1. Përdoret në prodhimin e birrës. 2. Oliver, aktor. 3. Barazim në tabela (shqiptimi). 5. Lumë i Siberisë. 6. Mbështillet në qafë. 8. Mund të jenë bilaterale. 10. Mblidhet në...kabinet. 12. Kush bën, nuk bën asgjë. 13. E mbaruar në afat. 15. Muzikë popullore. 16. Pak azotemi. 17. Ushtrohet nga diktatorët despotikë. 19. Vladimir, në Kremlin. 20. Hiset e ushqimit. 21. Një diamant artificial. 23. Kush nuk di, mbytet. 26. Kush nuk ka, nuk ha. 29. Sipas popullit, kur të del nga koka, je në hall të madh. 31. Vend i arit të kulluar, sipas Biblës. 34. Një thirrje në arenë. 35. Gjysmë acarim. 36. Pak tallës. 37. Letra e parë. 41. Notë muzikore. 42. Kat pa kokë.

HORIZONTALISHT: 1. ELB. 2. REED. 3. IKS. 5. VERTIKALISHT: 1. ERN. 4. FOSTER. 7. CALLAS. 43. TERR. 44. PALLATI.  
 33. NOSFERATU. 38. EL. 39. IT. 40. ITA. 28. MUN. 29. ARIA. 30. SOJA. 32. VIA. RACIONET. 21. STRASS. 23. NOT. 26. URI. TIPATIK. 24. AR. 25. CORRADI. 26. UNI. 27. SPOZIV. 21. SHEKULLORE. 22. AN-LEK. 9. BH. 11. BESSIE. 14. AFATE. 18. EK-OB. 6. SHALLI. 8. PIKEPAMJET. 10. OVE-RIA. 12. SEHIR. 13. E SKADUAR. 15. FOLK. 16. AZO. 17. TIRANIA. 19. PUTIN. 20. 29. AVULL. 31. OFIR. 34. OLE. 35. ACA. 36.

1		2	3		4	5	6	7	8		9
		10		11							
	12									13	
14									15		
16						17	18	19			
20				21	22						
	23		24								25
26									27	28	29
30					31		32				
33				34			35				
36				37	38	39		40			
			41								

**HORIZONTALISHT**

1. Bashkë me "one" në një kërcim të famshëm. 4. Janë ekstreme, kur janë kapitale. 10. Është policia e FBI-së. 12. Janë firmat rentiere. 14. Anarkist i famshëm. 15. Janë laboratorike në kimi. 16. Tase e volejbollit. 17. Papas, aktore. 20. Vegas, në Amerikë. 21. Bëhen për t'u mbajtur. 23. Mëdyshje. 26. Legjendat. 27. Kryeqyteti i Jemenit. 30. Në mitologji, braktisi Didonën. 31. Ushtarë amerikanë. 33. Parashtesë që kakuptimin katër. 35. Bëhen edhe si kujtim. 36. Radio Televizioni Italian. 37. Kantautor italian. 40. Hagen, këngëtare. 41. Nuk besojnë kollaj.

**VERTIKALISHT**

1. Përemër pyetës. 2. Rezultat i ilaçit. 3. Shtet me Limën kryeqytet. 4. Moore, aktore. 5. Sipas mitologjisë, ishin "furie" për romakët. 6. Ndërmarrje Autonome Durrës. 7. Sigla e dikurshme e Akademisë së Arteve. 8. Sëmundje e stomakut. 9. Përemër i gjuhës shqipe. 11. Nënshetasi e mbretit Hamlet. 12. Ishin mbrojtës të Karlit të Madh; mbrojtës të çështjeve të fisme. 13. Ato të gjakut nuk janë për t'u mbushur. 14. Ami, i Maupassant. 18. Gjysmë rini. 19. Programi televiziv. 22. Roma pa limite. 24. Mbreti shekspirian, babai i Regana-s. 25. Grupet e njerëzve me të njëjtën pozitë shoqërore. 26. Është kator për sipërfaqe. 28. Shumë i vjetër. 29. Ndrichojnë vitrina. 32. Rafa pa çifte. 34. Parku pa kufij. 38. Inicialet e Einstein-it. 39. Fillim Periudhe.

HORIZONTALISHT: 1. SA. 2. EFFKASITETI. 3. VERTIKALISHT: 1. SHTETI ME LIMEN. 2. MOORE. 3. SHTETI ME LIMEN. 4. MOORE. 5. SHTETI ME LIMEN. 6. SHTETI ME LIMEN. 7. SHTETI ME LIMEN. 8. SHTETI ME LIMEN. 9. SHTETI ME LIMEN. 10. SHTETI ME LIMEN. 11. SHTETI ME LIMEN. 12. SHTETI ME LIMEN. 13. SHTETI ME LIMEN. 14. SHTETI ME LIMEN. 15. SHTETI ME LIMEN. 16. SHTETI ME LIMEN. 17. SHTETI ME LIMEN. 18. SHTETI ME LIMEN. 19. SHTETI ME LIMEN. 20. SHTETI ME LIMEN. 21. SHTETI ME LIMEN. 22. SHTETI ME LIMEN. 23. SHTETI ME LIMEN. 24. SHTETI ME LIMEN. 25. SHTETI ME LIMEN. 26. SHTETI ME LIMEN. 27. SHTETI ME LIMEN. 28. SHTETI ME LIMEN. 29. SHTETI ME LIMEN. 30. SHTETI ME LIMEN. 31. SHTETI ME LIMEN. 32. SHTETI ME LIMEN. 33. SHTETI ME LIMEN. 34. SHTETI ME LIMEN. 35. SHTETI ME LIMEN. 36. SHTETI ME LIMEN. 37. SHTETI ME LIMEN. 38. SHTETI ME LIMEN. 39. SHTETI ME LIMEN. 40. SHTETI ME LIMEN. 41. SHTETI ME LIMEN.



**www.stranieriinitalia.it**

**Faqet internet të emigracionit**

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.

**Stranieri in Italia**



**Dashi (21 mars - 20 prill)**

Nëse keni prej kohësh partnerin, janari do t'ju sjellë dëshirën për ta ngacmuar, për t'i tërhequr vëmendjen dhe për të ndjellë xhelozinë e tij; e gjithë kjo për të gjallëruar marrëdhënien tuaj, për ta bërë më të paparashikueshme. Për të gjithë ata që janë vetëm, një takim me një të panjohur mund të ofrojë më shumë nga ç'parashikohej.



**Demi (21 prill - 20 maj)**

Janari do të jetë muaj i shkëlqyer për dashurinë, për t'u shënuar në librin e kujtimeve. Dashuria do të jetë për të gjithë ju gëzim, dëshirë për të lozur me partnerin, dëfrim që lind nga kënaqësia e pastër e të ndenjurit bashkë. Ata që ende nuk e kanë gjetur njeriun e zemrës të jenë të sigurt që me simpatinë e vet do të bëjnë për vete cilindo.



**Binjakët (21 maj - 21 qershor)**

Sfera sentimentale do të jetë e gjallëruar dhe do të japë plot kënaqësi sa do të duket si një ëndërr e realizuar. Pra, janari do të jetë muaj i magjishëm, i një mirëkuptimi të gjithashëm, mendor e shpirtëror, me partnerin; edhe sikur të doni, nuk do të gjeni dot një gjë që të mos shkojë në marrëdhënien tuaj.



**Gaforja (22 qershor - 22 korrik)**

Gjatë gjithë muajit do t'i drejtoni vetes shumë pyetje mbi jetën tuaj dashurore, gjë që do t'ju ndihmojë për të zbardhur pikat e errëta të saj. Duke u pyetur pse gjërat nuk shkonë siç dëshironi, mund të kuptoni se shumë varet pikërisht nga ju, nga dobësia apo pesimizmi juaj. Mundohuni të përmirësoheni në këtë drejtim.



**Luani (23 korrik - 23 gusht)**

Deri më datë 23 janar Afërdita do të jetë te Bricjapi, ju do të përjetoni një periudhë të qetë e të kënaqshme në dashuri: do të ndiheni të shpërblyer nga marrëdhënia e qëndrueshme që ju jep siguri, nga harmonia dhe mirëkuptimi me partnerin. Më pas do të keni ndonjë problem në jetën e çiftit. Për ata që janë vetëm, të reja pozitive.



**Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)**

Jeta sentimentale do të marrë nuanca interesante si asnjëherë tjetër, po të dini si të silleni në caste të caktuara. U vini veshin këshillave të Afërditës, në fushën e pestë, që ju fton të jeni të ëmbël dhe të dashur me partnerin si dhe të mirëkuptoni mendimet e veprimet e tij. Ata që ende nuk kanë partner, mund të përvëlohen nga një dashuri e re.



**Peshorja (23 shtator - 22 tetor)**

Gjatë muajit janar do të përjetoni ndjesinë e pakënaqësisë, të parhatisë, sikur gjithçka të shkonte kundër jush në jetën sentimentale. Në përgjithësi, do të jetë një ndjesi subjektive, e pajustificueshme nga ngjarjet e faktet konkrete. Mundohuni të kuptoni se ku ngec marrëdhënia juaj dhe përpiquni ta ndreqni në atë drejtim.



**Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)**

Disa planetë ju mbështesin dhe do të bëjnë të mundur të keni takime shumë interesante; në ndonjë rast, do të lindin histori dashurore jetëgjata e plot pasion. "Futuni punës" nëse e keni zemrën të lirë. Nëse e keni njeriun, gjatë janarit do të gjeni gjithnjë fjalët dhe veprimet e duhura për të shprehur gjithçka provoni për të, gjë që do ta kënaqë.



**Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)**

Janari do të jetë muaj i bukur për ata që i përket dashurisë, sigurisht nëse keni një marrëdhënie të konsoliduar. Mirëkuptimi me partnerin do të përforcohet nga fakti që keni të njëjtën shkallë vlerash që ju lejon të jeni dakord në çdo hap që hidhni. Muaji do të jetë emocionues dhe për të vetmuarit që janë të predispozuar të kenë takime interesante.



**Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)**

Afërdita që po kalon në shenjën tuaj, ju dhuron javë të lumtura në dashuri. Fillimi i vitit do të jetë periudhë e bukur për të gjithë ata që janë çift: mirëkuptimi do të jetë i shkëlqyer. Nëse jeni vetëm, nuk do t'ju mungojnë rastet të shoqërohemi me persona interesantë, qoftë edhe për pak orë dhe pa u angazhuar seriozisht.



**Ujori (21 janar - 19 shkurt)**

Në janar, dashuria do të karakterizohet nga ëmbëlsia dhe romanticizmi. Do të keni dëshirë të ëndërroni, të kërkonti ëmbëlsi dhe caste romantike. Nëse jeni të lumtur me jetën e çiftit, gjithçka do t'ju shkojë vaj, por nëse marrëdhënia juaj po kalon periudhë krize, do të jetë e pashmangshme prishja përfundimtare.



**Peshqit (20 shkurt - 20 mars)**

Planetët ju sigurojnë një muaj të shkëlqyer, gjatë të cilit mund të realizoni relativisht lehtë çdo ëndërr dhe dëshirë dashurore. Nëse keni një histori të gjatë dashurore, papritur do të zbuloni anët e saj më eksituese, aspektet e saj më nxitëse që kishit harruar përkohësisht. Të vetmuarit do të kenë takime më të rëndësishme nga ç'i mendonin.

# CATWALK

IL NEGOZIO DI ALTA MODA A TIRANA

Ermenegildo Zegna

CESARE PACIOTTI

GIANFRANCO FERRE

CERRUTI 1881



ONI PUSTINA

RRUGA MUSLYM SHYRI, TIRANA



# TANI! KOMISIONE TË REJA PËR NË SHQIPËRI

Dërgo deri në 100 Euro vetëm me **7 Euro\***!

Komisionet janë të vlefshme për dërgesa në Shqipëri nga Lombardia, Emilia Romagna, Piemonte, Liguria, Valle d'Aosta, Trentino Alto Adige, Veneto dhe Friuli Venezia Giulia.

\*Përveç komisionit të transfertës Western Union përfiton para shtesë kur këmben paratë tuaja në monedhën vendase. Komisionet janë të vlefshme për një periudhë të pa përcaktuar duke filluar nga 28 Janar 2008.

© 2008 WESTERN UNION HOLDINGS, INC. All rights reserved. www.wu.com

# WESTERN | UNION |